



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.32

29 mars

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9691
datë 8.3.2007

Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin me kredi të projektit “Ndërtimi i terminalit të trageteve dhe shesheve përreth në Portin e Durrësit””

581

Ligj nr.9692
datë 8.3.2007

Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi (OPRC), 1990”

601

LIGJ
Nr.9691, datë 8.3.2007

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EUROPIANE TË
INVESTIMEVE (BEI) PËR FINANCIMIN ME KREDI TË PROJEKTIT “NDËRTIMI I
TERMINALIT TË TRAGETEVE DHE SHESHEVE PËRRETH NË PORTIN E DURRËSIT””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve (BEI) për financimin me kredi të projektit “Ndërtimi i terminalit të trageteve dhe shesheve përreth në Portin e Durrësit””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.5238, datë 20.3.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

FI No (AL)
SERAPIS No 2004-0333

TERMINALI I TRAGETEVE NË PORTIN E DURRËSIT

Kontratë financimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve
Tiranë, 27 dhjetor 2006

Kjo kontratë lidhet ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Kryeministër z.Sali Berisha nga njëra anë dhe

Bankës Europiane të Investimeve (këtu e tutje referuar si “Banka”), me seli në Luksemburg, përfaqësuar nga zëvendësudrejtori z.Manfredi Tonci Ottieri dhe Shefi i Divizionit z.Romualdo Massa Bernucci, nga ana tjetër;
ndërsa

1.Republika e Shqipërisë (që vepron nëpërmjet Ministrisë së saj të Financave, e quajtur “Huamarrësi”) ka deklaruar se ndërmerr një projekt (këtu e tutje i referuar si “Projekti”) nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, këtu e tutje i quajtur “Promovuesi”) dhe Autoritetit të portit të Durrësit (këtu e tutje i referuar si “Përfituesi”) që konsiston në ndërtimin e një terminali të ri tragetesh për pasagjerët, me ambiente ndihmëse në Portin e Durrësit, porti kryesor i Shqipërisë mbi detin Adriatik. Projekti përfshin një ndërtesë me ambiente për pasagjerët dhe shoferët e automjeteve, trajtimin të procedurave doganore, zona sirenash të shtruara dhe lidhje kalimi, si dhe punime mbështetëse që lindin nga rirregullimi i operacioneve ekzistuese të ngarkesës së portit, siç përshkruhet në formë më të detajuar në përshkrimin teknik (këtu e tutje referuar si “Përshkrimi teknik”), përcaktuar në programin A.1 të saj.

2. Kostoja totale e projektit që duhet financuar, siç vlerësohet nga Banka, është si më poshtë:

Burimi**Sasia (M EUR)**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë	EUR 5.8
Fondet e Komisionit të BE-së	EUR 2.2
Kredia nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim	EUR 14.0
Kredi nga Banka	EUR 18.0
Totali	EUR 40.0

3. Me qëllim realizimin e planit të financimit të përcaktuar në pikën (2), Huamarrësi i ka kërkuar Bankës një kredi të barasvlefshme me shumën prej 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milionë eurosh).

4. Marrëveshja kuadër që rregullon aktivitetet e Bankës në territorin e Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 5 shkurt 1998 nga Huamarrësi dhe Banka (këtu e tutje referuar si "Marrëveshja kuadër") është e zbatueshme për këtë kontratë.

5. Në përgjigje të kërkesës së Huamarrësit, duke qenë e bindur se financimi i projektit hyn brenda fushës së veprimit të funksioneve të saj dhe ndër të tjera, duke u mbështetur në deklaratat dhe faktet e cituara në pikat përkatëse, Banka është e gatshme të vërë në dispozicion të Huamarrësit një kredi të barasvlefshme me shumën prej 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milionë eurosh), sipas kësaj kontrate financimi (këtu e tutje referuar si "Kontrata").

6. Statuti i Bankës parashikon që Banka të sigurojë që fondet e saj të përdoren në mënyrë sa më racionale në interes të Bashkimit Europian dhe në mënyrën e duhur, si dhe termat dhe kushtet e operacioneve të huasë së saj të jenë në përputhje me politikat e Bashkimit Europian.

7. Referencat këtu ndaj neneve, pikave dhe programeve janë referenca përkatësisht ndaj neneve, pikave dhe programeve të kësaj kontrate, kështu, është rënë dakord si më poshtë:

Neni 1**Kredia dhe disbursimi****1.01 Sasia dhe alokimi i huasë**

Me anë të kësaj kontrate, Banka krijon në favor të Huamarrësit dhe Huamarrësi pranon një kredi (këtu e tutje referuar si "Kredia") në një shumë të barasvlefshme me 18,000,000 (tetëmbëdhjetë milionë euro) për financimin e projektit.

1.02 Procedura e disbursimit**1.02(1) Transhet**

Banka e disburson kredinë deri në gjashtë (6) transhe. Sasia e secilit transh, nëse nuk është transhi i fundit, do të jetë minimumi i barasvlerës prej 3,000,000 (tre milionë) eurosh. Një transh i kërkuar nga Promovuesi, në përputhje me nenin 1.02 (2), referohet këtu e tutje si "Transhi".

1.02(2) Kërkesa e disbursimit

Herë pas here, deri në datën 10 dhjetor 2010, Promovuesi mund t'i paraqesë Bankës një kërkesë me shkrim, (një "Kërkesë disbursimi"), kryesisht në formën e përcaktuar në programin C, për disbursimin e një transhi. Kërkesa e disbursimit specifikon:

i) Sasinë dhe monedhën e disbursimit të transhit;

ii) Datën e preferuar për disbursim, e cila do të jetë një ditë përkatëse pune (siç përcaktohet në nenin 5.01), që nuk është më tepër se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike pas datës së kërkesës së disbursimit, duke nënkuptuar se Banka mund ta disbursojë transhin deri në katër (4) muaj pas datës së kërkesës së disbursimit;

iii) Nëse transhi ka një normë të caktuar interesi (d.m.th. është një "Transh me interes fiks" ose një normë interesi e ndryshueshme me një shtrirje të caktuar (d.m.th. një "Transh me normë të ndryshueshme interesi, me shtrirje të caktuar" ose "Transh FSFR"), siç parashikohet në dispozitat përkatëse të nenit 3.01;

iv) Termat e preferuara për shlyerjen e principalit, të zgjedhura në përputhje me nenin 4.01;

v) Datat e preferuara të pagesës, të zgjedhura në përputhje me nenin 5.01; dhe

vi) Nëse disbursimi synon financimin e punimeve civile.

Promovuesi, gjithashtu, sipas zgjedhjes së tij, mund të specifikojë në kërkesën e disbursimit elementet përkatëse të mëposhtme, nëse ka, siç tregohen nga Banka, pa zotimin për detyrimin financiar që duhet të zbatohet për transhin gjatë kohëzgjatjes së tij, domethënë:

i) në rastin e një transhi me interes fiks, interesin fiks; dhe

ii) në rastin e një transhi FSFR, shtrirjen (siç përcaktohet në nenin 3.01).

Për qëllime të kësaj kontrate, përgjithësisht “Norma ndërbankare përkatëse” nënkupton:

- EURIBOR në rastin e një transhi të emërtuar në euro;
- LIBOR në rastin e një transhi të emërtuar në GBP ose USD; dhe
- Normën e tregut dhe përcaktimin e saj të zgjedhur nga Banka dhe komunikuar, veçmas Promovuesit, në rastin e një transhi të emërtuar në ndonjë monedhë tjetër.

Duke iu nënshtruar paragrafit të dytë të fundit të nenit 1.02(3), çdo kërkesë disbursimi është e pakthyeshme.

1.02 (3) Njoftimi i disbursimit

Brenda periudhës prej dhjetë (10) dhe pesëmbëdhjetë (15) ditësh para datës së disbursimit të një transhi, nëse kërkesa e disbursimit është në pajtim me nenin 1.02 (2), Banka i dorëzon Huamarrësit, Promovuesit dhe Përfituesit një njoftim (këtu e tutje i referuar si “Njoftim disbursimi”), i cili specifikon:

- i) sasinë dhe monedhën e disbursimit;
- ii) datën në të cilën është planifikuar që të disbursohet transhi (këtu e tutje referuar si “Data e planifikimit të transhit”), disbursim që në çdo rast i nënshtrohet kushteve të nenit 1.04;
- iii) bazën e normës së interesit;
- iv) për një transh me normë fikse, normën fikse të interesit dhe për një transh FSFR, shtrirjen;
- v) termat për shlyerjen e principalit dhe periodicitetin e pagesës së interesit; dhe
- vi) datën e zbatueshme të pagesës.

Nëse një ose më shumë elemente të specifikuara në njoftimin e disbursimit nuk janë në përputhje me elementin korrespondues, nëse ka, në kërkesën e disbursimit, Promovuesi brenda tre (3) ditësh pune Luksemburgu pas marrjes së njoftimit të disbursimit mund ta anulojë kërkesën e disbursimit me anë të një njoftimi drejtuar Bankës dhe për pasojë, kërkesa e disbursimit dhe njoftimi i disbursimit nuk do të kenë efekt.

Për qëllime të kësaj kontrate, përgjithësisht “Ditë pune Luksemburgu” nënkupton një ditë në të cilën bankat tregtare janë të hapura për gjendje pune në Luksemburg.

1.03 Monedha dhe llogaria e disbursimit

1.03 (1) Monedha e disbursimit

Kushtëzuar nga disponueshmëria, Banka disburson çdo transh në monedhën për të cilën ka shprehur preferencë Promovuesi. Çdo monedhë disbursimi do të jetë në EURO, USD ose GBP, ose në ndonjë monedhë tjetër që tregtohet gjerësisht në tregjet kryesore të huaja të shkëmbimit valutor dhe që në rastin e një transhi FSFR, është një monedhë që i vihet në dispozicion Bankës në norma të ndryshueshme interesi.

Për llogaritjen e shumave në dispozicion që duhen disbursuar në monedha të ndryshme nga euro dhe për të vendosur barasvlerën e tyre në euro, Banka zbaton normën e publikuar nga Banka Qendrore Europiane në Frankfurt në këtë datë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh para disbursimit, siç mund ta vendosë Banka.

1.03 (2) Llogaria e disbursimit

Sasia e çdo transhi do të disbursohet nga Banka në emër dhe në llogari të Huamarrësit me anë të transfertës në një llogari të veçantë të hapur në emër të Huamarrësit me Bankën Qendrore të Shqipërisë dhe që mban një numër që i duhet komunikuar me shkrim Bankës nga një nëpunës i autorizuar rregullisht i Huamarrësit, që shoqëron kërkesën e parë të disbursimit.

Huamarrësi pohon se çdo transfertë të një sasia nga Banka në mënyrën e përcaktuar më sipër, do të rrisë bilancin e papaguar të huasë (siç përcaktohet më poshtë) nga sasia që duhet transferuar.

1.04 Kushtet e disbursimit

1.04 (1) Transhi i parë

Disbursimi i transhit të parë, sipas kësaj kontrate, i nënshtrohet Bankës që ka marrë nga Huamarrësi dhe sipas rastit nga Promovuesi në ose para datës që përkon me shtatë (7) ditë pune Luksemburgu para datës përkatëse të planifikuar të disbursimit:

- i) një opinion ligjor të shprehur nga Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë që konfirmon:
 - a) se ekzekutimi i kontratës është autorizuar siç duhet nga një vendim i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë; që nënshkruesit e kësaj kontrate janë të autorizuar rregullisht për ta nënshkruar këtë kontratë në emër të Republikës së Shqipërisë; që kjo kontratë hyn brenda fushës së veprimit të Marrëveshjes kuadër; që Parlamenti i Republikës së Shqipërisë e ka ratifikuar këtë kontratë; që dispozitat e kësaj kontrate janë në fuqi të plotë dhe se është e vlefshme, detyruese dhe e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë në përputhje me termat e saj;
 - b) fakte ose prova të autoritetit të personit ose personave të autorizuar për nënshkrimin e kërkesave të disbursimit dhe modele autentike firmash të këtij personi ose të këtyre personave; dhe

c) se janë siguruar të gjitha miratimet e kontrollit të nevojshëm të shkëmbimit, me qëllim që Huamarrësi të lejohet të marrë shuma të disbursuara sipas kësaj, për të shlyer huanë dhe për të paguar interesin dhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme, sipas kësaj kontrate dhe se këto miratime shtrihen në hapjen dhe ruajtjen e llogarive, të cilat Huamarrësi do ta drejtojë Bankën për të disbursuar kredinë;

ii) prova se është krijuar një njësi zbatimi projekti “NJZP”, në përputhje me kërkesat e Bankës dhe se NJZP-ja është e pajisur me personel të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe të përkushtuar për bashkërendimin dhe menaxhimin e projektit;

iii) prova për rekrutimin e një konsulenti me përvojë ndërkombëtare, sipas pëlqimit të Bankës, me qëllim që ta ndihmojë NJZP-në në proceset e tenderimit dhe në menaxhimin e projektit.

1.04 (2) Të gjitha transhet

Për më tepër, disbursimi i çdo transhi sipas nenit 1.02, duke përfshirë të parin, i nënshtrohet Bankës që ka marrë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, në ose para datës që përkon me shtatë (7) ditë pune Luksemburgu, para datës përkatëse të planifikuar të disbursimit:

i) prova se Promovuesi ka bërë ose është zotuar nga ana kontraktuale deri në datën e kërkesës për disbursim të bëjë shpenzime kualifikuese brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas datës përkatëse të planifikuar për disbursim, në një shumë të paktën të barabartë me totalin e 80 % të shumës së transhit, që duhet disbursuar dhe të gjitha transheve paraprirëse, nëse ka; “Shpenzimet kualifikuese” nënkuptojnë shpenzimet (duke përfshirë kostot e planifikimit dhe mbikëqyrjes, sipas rastit, dhe rrjetin e taksave dhe tatimeve të pagueshme nga Promovuesi) të bëra nga Promovuesi në lidhje me punimet, mallrat dhe shërbimet mbi zërat e specifikuar në përshkrimin teknik, si të pranueshme për financim sipas kredisë;

ii) prova se fondet e përmendura në pikën (2) për zbatimin e projektit i vihen në dispozicion Promovuesit;

iii) prova, nëse ka, se zbatimi i projektit duket i pranueshëm për Bankën;

iv) një konfirmim i kohëve të fundit nga Huamarrësi se nuk kërkohen miratime shtesë të kontrollit të shkëmbimit, me qëllim që të lejojnë marrjen e shumës së transhit, që duhet disbursuar si më poshtë, shlyerjen e huasë dhe pagimin e të gjitha interesave dhe sasive të tjera të pagueshme, sipas kësaj kontrate; dhe

v) prova të autoritetit të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar kërkesat e disbursimit dhe modelin autentik të firmës së këtij personi ose personave, nëse ndryshojnë nga personi ose personat e autorizuar për të nënshkruar kërkesën e parë të disbursimit.

Për llogaritjen e barasvlerës në euro të shumave të shpenzuara, Banka alokon normën e shkëmbimit të referuar në nenin 1.03.

1.04 (3) Transhi i fundit

Paraqitja e kërkesës së fundit për disbursim sipas nenit 1.02 (1), i nënshtrohet Bankës që ka marrë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për të, nga Promovuesi, dokumente që tregojnë, sipas kërkesave të bankës, se mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që Promovuesi të ketë bërë deri në ditën e 90-të që përkon pas datës së preferuar për këtë disbursim të specifikuar në kërkesën për disbursim, shpenzimet kualifikuese në një shumë të paktën të barabartë me totalin e 100 % të shumave të të gjitha transheve të disbursuara më parë dhe të transhit që duhet disbursuar.

1.04 (4) Transhet në lidhje me kontratat e punimeve civile

Pa cenuar ndonjë kusht tjetër të përcaktuar në këtë nen në pikën 1.04, disbursimi i parë i synuar për financimin e punimeve civile i nënshtrohet më tej Bankës që ka marrë nga Promovuesi në ose para datës që përkon me shtatë (7) ditë pune Luksemburgu para datës së planifikuar të disbursimit: (i) konfirmim të rekrutimit të një konsulenti me përvojë ndërkombëtare, sipas pëlqimit të Bankës, me qëllim që të mbikëqyrë punimet në përputhje me rregullat FIDIC, dhe (ii) prova të lejes përkatëse të ndërtimit, të miratuar sipas të gjitha rregullave nga Ministria e Mjedisit dhe e Planit të Menaxhimit Mjedisor të Republikës së Shqipërisë.

1.04(5) Dispozita të përgjithshme mbi kushtet e disbursimit

Në rast se është bërë një kërkesë disbursimi pa plotësimin e kushteve të parashtruara në nenin 1.04, kjo kërkesë disbursimi çmohet të jetë marrë nga Banka në datën në të cilën Banka është bindur se këto kushte janë plotësuar.

Pavarësisht nga dispozita e paragrafit paraprirës, nëse ndonjë pjesë e dokumenteve të marra, sipas nenit 1.04, nuk është sipas kërkesave të Bankës, Banka mund ta disbursojë pa cenuar sasinë minimale të përcaktuar në nenin 1.02 (1), një sasi të barabartë me sasinë që i nënshtrohet kërkesës së disbursimit, më pak se sasia që i korrespondon shpenzimeve të bëra kualifikuese të parashikuara dhe të padokumentuara.

1.05 Shtyrja e disbursimit

1.05 (1) Arsyet për shtyrje

Sipas një kërkesë me shkrim të Promovuesit, Banka mund ta shtyjë disbursimin e ndonjë transhi, tërësisht ose pjesërisht, deri në një datë të specifikuar nga Promovuesi, që përkon me jo më shumë se gjashtë (6) muaj nga data e planifikuar e disbursimit. Në këtë rast, Huamarrësi paguan dëmshpërblimin e shtyrjes së disbursimit, siç përcaktohet sipas nenit 1.05 (2) më poshtë. Çdo kërkesë për shtyrje disbursimi ka efekt në lidhje me një transh, vetëm nëse bëhet të paktën shtatë (7) ditë pune Luksemburgu para datës së planifikuar të disbursimit.

Nëse ndonjë prej kushteve të referuara në nenin 1.04 nuk është plotësuar në datën e specifikuar, disbursimi shtyhet deri në një datë të rënë dakord ndërmjet Bankës dhe Promovuesit që përkon jo më pak sesa shtatë (7) ditë pune Luksemburgu pas plotësimit të të gjitha kushteve të disbursimit, sipas kërkesave të Bankës.

1.05 (2) Garancia për shtyrjen e disbursimit

Nëse disbursimi i ndonjë transhi të njoftuar (siç përcaktohet më poshtë në këtë nen 1.05 (2)) është shtyrë, qoftë më kërkesë të Promovuesit siç përcaktohet në nenin 1.05 (1) ose për shkak të mosplotësimit të kushteve të disbursimit, Promovuesi, sipas kërkesës së Bankës, paguan një dëmshpërblim mbi shumën, disbursimi i të cilës është shtyrë. Ky dëmshpërblim akumulohet nga data e planifikuar e disbursimit deri në datën e tashme të disbursimit ose, sipas rastit, deri në datën e anulimit të transhit me një shkallë të barabartë me R1 minus R2, ku:

R1 është shkalla e interesit që do të zbatohet herë pas here në pajtim me nenin 3.01 dhe njoftimi përkatës i disbursimit, nëse transhi do të ishte disbursuar në datën e planifikuar të disbursimit; dhe

R2 është shkalla përkatëse ndërbankare minus 0.125% (12.5 pikë bazë); me kusht që për qëllimin e shkallës përkatëse ndërbankare në lidhje me këtë nen 1.05 afatet përkatëse, të parashikuara në planin kohor II, janë afatet pasuese të një (1) muaji që fillon në datën e planifikuar të disbursimit.

Për më tepër, garancia:

a) nëse shtyrja tejkalon një (1) muaj në kohëzgjatje, akumulohet në fund të çdo muaji dhe është e pagueshme në pajtim me nenin 1.07;

b) llogaritet duke përdorur konventën e numërimit të ditëve që zbatohet për R1;

c) nëse R2 tejkalon R1, caktohet te zero; dhe

d) paguhet në pajtim me nenin 1.07.

Në këtë kontratë “Transh i njoftuar” është një transh, në lidhje me të cilën Banka ka lëshuar një njoftim disbursimi.

1.05(3) Anulimi i disbursimit të shtyrë për gjashtë muaj

Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund ta anulojë një disbursim që është shtyrë në bazë të nenit 1.05(1) për më shumë se (6) muaj në total. Shuma e anuluar mbetet e disponueshme për disbursim në bazë të nenit 1.02.

1.06 Anulimi dhe pezullimi

1.06(1) E drejta e Huamarrësit për të anuluar

Promovuesi në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Bankës, mund të anulojë, pjesërisht ose plotësisht dhe me efekt të menjëhershëm, pjesën e padisbursuar të kredisë. Megjithatë, njoftimi nuk ka efekt në lidhje me një transh, data e planifikuar e disbursimit të të cilit përkon brenda shtatë (7) ditëve pune të Luksemburgut pas datës së njoftimit.

1.06(2) E drejta e Bankës për të pezulluar dhe anuluar

Banka, duke njoftuar Promovuesin, mund ta pezullojë dhe/ose anulojë, pjesërisht ose plotësisht, pjesën e disbursuar të kredisë në çdo kohë, dhe me efekt të menjëhershëm:

i) me rastin e një ngjarjeje të përmendur në nenin 10.01; dhe

ii) në rrethana të veçanta që ndikojnë negativisht në hyrjen e Bankës në tregun e kapitaleve, përveç se sipas transhit të njoftuar.

Për më tepër, në masën që Banka mund ta anulojë kredinë në bazë të nenit 4.03(1), Banka mund ta anulojë atë. Çdo anulim vazhdon derisa Banka përfundon pezullimin ose anulon shumën e pezulluar.

1.06(3) Garancia për pezullimin dhe anulimin e një transhi

1.06(3)(i) Pezullimi

Nëse Banka pezullon një transh të njoftuar në një ngjarje të përmendur në nenin 10.01, por jo ndryshe, Huamarrësi zhdëmton Bankën në bazë të nenit 1.05(2).

1.06(3)(ii) Anulimi

Nëse një transh i njoftuar me një normë fikse anulohet nga Promovuesi, në pajtim me nenin 1.06(1) të mësipërm, Huamarrësi zhdëmton Bankën në bazë të nenit 4.02(2)(i). Nëse një pjesë e kredisë e ndryshme nga transhi i njoftuar i normës fikse anulohet nga Promovuesi në pajtim me nenin 1.06(1) të mësipërm, nuk paguhet asnjë garanci.

Nëse Banka anulon një disbursim të transhit me normë fikse, në pajtim me nenin 1.05(3), Huamarrësi zhdëmton Bankën në pajtim me nenin 4.02(2)(i). Nëse Banka anulon një transh të njoftuar me rastin e një ngjarjeje të përmendur në nenin 10.01, Huamarrësi zhdëmton Bankën në bazë të nenit 10.03. Përveç këtyre rasteve, asnjë garanci nuk paguhet me anulimin nga Banka.

Një garanci llogaritet mbi bazën që shuma e anuluar konsiderohet të jetë disbursuar dhe shlyer në datën e planifikuar të disbursimit ose, në masën që disbursimi i transhit tashmë shtyhet ose pezullohet, në datën e njoftimit të anulimit.

1.06(4) Anulimi pas skadimit të kredisë

Në çdo kohë pas afatit të fundit të Promovuesit për paraqitjen e kërkesës së disbursimit, Banka, duke njoftuar Promovuesin, dhe pa pasur detyrim nga ana e asnjë pale, mund të anulojë çdo pjesë të kredisë të ndryshme nga transhi i njoftuar.

1.07 Shumat e kërkueshme sipas nenit 1

Shumat e kërkueshme, sipas neneve 1.05 dhe 1.06, janë të pagueshme në monedhën e transhit përkatës. Ato paguhen brenda (7) ditëve nga marrja nga Promovuesi të kërkesës së Bankës ose brenda një afati tjetër të përcaktuar nga njoftimi i Bankës për kërkesën.

Neni 2

Huaja

2.01 Shuma e huasë

Huaja e marrë sipas kredisë (këtu e tutje referuar si “Huaja”), përbëhet nga totali i shumave të disbursuara nga Banka në monedhën e disbursimeve, sipas njoftimit të Bankës me rastin e disbursimit të secilit transh.

2.02 Monedha e shlyerjeve

Çdo shlyerje transhi në bazë të nenit 4, ose sipas rastit, nenit 10, është në monedhën e transhit.

2.03 Monedha e interesit dhe e pagesave të tjera

Interesi dhe çdo pagesë tjetër e zbatueshme, e pagueshme nga Huamarrësi në bazë të neneve 3, 4 dhe, sipas rastit, 10, llogaritet dhe është e pagueshme në lidhje me çdo transh në monedhën e transhit.

Çdo pagesë tjetër bëhet në monedhën e përcaktuar nga Banka, duke pasur parasysh monedhën e shpenzimit që rimbursohet me anë të asaj pagese.

2.04 Konfirmimi nga Banka

Pas çdo disbursimi të një transhi, Banka i paraqet Huamarrësit dhe Promovuesit një deklaram përmbledhës që tregon datën e disbursimit, monedhën dhe shumën, termat e shlyerjes dhe shkallën e interesit të dhe për atë transh. Një konfirmim i tillë përfshin tabelën e amortizimit.

Neni 3

Interesi

3.01 Norma e interesit

3.01(1) Transhet me normë fikse

Huamarrësi paguan interes për balancën e mbetur të çdo transhi me normë fikse në çdo gjysmë viti në shumat për datat përkatëse të pagesave, sipas parashikimit të njoftimit përkatës të disbursimit, duke filluar në datën e parë të pagesave të tilla pas datës së disbursimit të transhit.

Interesi llogaritet mbi bazën e nenit 5.02(i) me bazë vjetore që është norma fikse.

Në këtë kontratë, norma fikse është norma vjetore e interesit e përcaktuar nga Banka, në pajtim me parimet e zbatueshme, herë pas here të përcaktuara nga organet e Bankës për huatë e përcaktuara me një normë të fiksuar interesi, të emërtuara në monedhën e transhit dhe që ka terma të barasvlefshme për shlyerjen e kapitalit dhe pagesën e interesit.

3.01(2) Transhet me normë të ndryshueshme me shtrirje fikse

Huamarrësi paguan interes për balancën e mbetur për çdo transh FSFR në FSFR (siç përcaktohet më poshtë) çdo gjysmë viti për shumat e datave përkatëse të pagesës, sipas përcaktimit të njoftimit përkatës të disbursimit.

Banka e njofton FSFR-në, Huamarrësin brenda dhjetë (10) ditëve pas fillimit të çdo afati reference

të FSFR-së.

Interesi llogaritet në lidhje me çdo periudhë reference të FSFR-së, në bazë të nenit 5.02(ii).

Në këtë kontratë:

“FSFR-ja” është një normë interesi e ndryshueshme me shtrirje fikse, që është një normë vjetore interesi e barabartë me normën përkatëse ndërbankare ose minus shtrirjen, e përcaktuar nga Banka për çdo afat reference të FSFR-së.

“Afat reference i FSFR-së” është çdo afat prej (6) muajsh, nga një datë pagese në datën tjetër përkatëse të pagesës, me kusht që afati i parë i referencës së FSFR-së të fillojë në datën e disbursimit të transhit.

“Shtrirje” është ajo shtrirje e përcaktuar në shkallën përkatëse ndërbankare (qoftë minus ose plus), e përcaktuar nga Banka dhe i njoftohet Huamarrësit në njoftimin përkatës të disbursimit.

3.02 Interesi për shumat e papaguara

Pa cenuar nenin 10 dhe nëpërmjet përjashtimit të nenit 3.0, interesi mbledhet për çdo shumë të papaguar, që paguhet në pajtim me kushtet e kësaj kontrate nga data e kërkueshme në datën e pagesës, në një normë vjetore të barabartë me normën përkatëse ndërbankare, plus 2% (200 pikë bazë) dhe është e pagueshme në pajtim me kërkesën e Bankës. Për qëllimin e përcaktimit të normës përkatëse ndërbankare në lidhje me këtë nen 3.02, afatet përkatëse brenda kuptimit të planit kohor II janë afate pasuese prej një (1) muaji që fillon në datën e kërkueshme.

Megjithatë transhi me normë të përcaktuar vendoset në një normë vjetore, që është shuma e normës së interesit të përcaktuar në pajtim me nenin 3.01(1) plus 0.25% (25 pikë bazë), nëse kjo normë vjetore tejkalon në një afat të caktuar shkallën e përcaktuar në paragrafin e mësipërm.

Nëse shuma e kërkueshme është në një monedhë tjetër nga monedha e transhit, zbatohet norma e mëposhtme për vit, kryesisht norma përkatëse ndërbankare që përgjithësisht mbahet nga Banka për transaksionet në atë monedhë plus 2% (200 pikë bazë), të llogaritura në pajtim me praktikën për këtë qëllim.

Neni 4 Shlyerja

4.01 Shlyerja normale

Huamarrësi shlyen çdo transh me këste në datat e pagesës, sipas përcaktimit në bazë të nenit 5.01, dhe përcaktuar në njoftimin përkatës të disbursimit, në pajtim me kushtet e tabelës së amortizimit të nxjerrë në pajtim me nenin 2.04.

Çdo tabelë amortizimi hartohet mbi bazën që:

i) të bëhet shlyerja e një transhi;

a) në rastin e një transhi me normë fikse çdo gjysmë viti; (i) në këste të barabarta të principalit ose (ii) mbi nja bazë konstante vjetore, që shuma e përgjithshme e totalit dhe interesi i kërkueshëm në lidhje me transhin të jetë afërsisht sa më i njëjtë në çdo datë pagese; dhe

b) në rastin e një transhi FSFR-ja çdo gjysmë viti në këste të barabarta të principalit; dhe

ii) data e parë e shlyerjes së çdo transhi është një datë pagese që bie më ose jo më vonë se data e parë e pagesës, menjëherë pas përvjetorit të pestë të datës së planifikuar të disbursimit të transhit dhe data e fundit e pagesës është data e pagesës që bie jo më parë se katër (4) vjet dhe jo më vonë se njëzet (20) vjet nga data e planifikuar e disbursimit.

Data e fundit e shlyerjes, e përcaktuar në pajtim me nenin 4.01, këtu referohet si datë maturimi.

4.02 Parapagimi vullnetar

4.02(1) Opsioni i parapagimit

Në pajtim me nenet 4.02(2) dhe 4.03(3), Huamarrësi mund të ripagujë të gjithë ose një pjesë të një transhi, së bashku me interesin e mbledhur, duke dhënë një (1) muaj njoftim paraprak (këtu quhet “Njoftimi i parapagimit”), duke përcaktuar shumën e saj për t’u parapaguar (“Shuma e parapagimit”) dhe datën në të cilën Huamarrësi propozon për kryerjen e parapagimit (“Data e parapagimit”), datë që është data e pagimit për atë transh.

4.02(2) Garancia e parapagimit

4.02(2)(i) Transhi me normë fikse

Në lidhje me çdo shumë të parapagimit të një transhi me normë fikse, Huamarrësi i paguan Bankës në datën e parapagimit një garanci të barabartë me vlerën e tashme (sa të datës së parapagimit) të shtesës, nëse ka:

i) për interesin që do të mblidhej pas kësaj për shumën e parapagimit gjatë periudhës nga data e parapagimit në datën e maturimit, nëse nuk ishte parapaguar;

ii) për interesin që do të mblidhej për atë periudhë, nëse ai llogaritet në datën e rishpërndarjes së EIB-së (sipas përcaktimit më poshtë) minus 15 pikë bazë.

Kjo vlerë e tashme llogaritet si një shkallë kontoje të barabartë me gjysmën e normës së rishpërndarjes, të zbatuar në çdo datë përkatëse të pagesës.

Në këtë kontratë, “Norma e rishpërndarjes EIB” është norma fikse në fuqi një (1) muaj para datës së shlyerjes dhe që ka një afat të njëjtë për pagesën e interesit dhe të njëjtin profil shlyerjeje për datën e maturimit si shumën e parapagimit.

4.02(2)(ii) Transhi i FSFR-së

Huamarrësi mund të përgatitë një transh FSFR-je me garanci në çdo datë pagese përkatëse.

4.02(3) Mekanizmi i parapagimit

Banka njofton Huamarrësin, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së parapagimit, për shumën e parapagimit, për interesin e akumuluar, dhe, në rastin e parapagesës së një transhi me normë fikse, për garancitë e pagueshme në bazë të nenit 4.02(2) ose, sipas rastit, nuk është e kërkueshme asnjë garanci.

Jo më vonë se afati i fundit (siç përcaktohet më poshtë), Huamarrësi njofton Bankën:

i) që konfirmon njoftimin e parapagimit me kushtet e përcaktuara nga Banka; ose

ii) që tërheq njoftimin e parapagimit.

Nëse Huamarrësi jep konfirmim në bazë të (i), ai kryen parapagimin. Nëse Huamarrësi tërheq njoftimin e parapagimit apo nuk e konfirmon atë në kohën e duhur, ai nuk mund ta bëjë parapagimin. Përveçse sa më sipër, njoftimi i parapagimit është detyrues dhe i parëvokueshëm.

Huamarrësi shoqëron parapagimin me pagesën e interesit të akumuluar dhe garancinë, sipas rastit, të kërkueshme mbi shumën e parapagimit.

Për qëllim të këtij neni 4.02, “Afati i pranueshmërisë” për një njoftim është:

i) 16h00 ora e Luksemburgut në ditën e dorëzimit, nëse njoftimi është bërë në 14h00 në një ditë pune të Luksemburgut; ose

ii) 11h00 në ditën pasuese që është një ditë pune e Luksemburgut, nëse njoftimi jepet pas 14h00, sipas orës së Luksemburgut në një ditë të tillë ose jepet në një ditë, e cila nuk është një ditë pune e Luksemburgut.

4.03 Parapagimi detyrues

4.03(1) Shkaqet për parapagim

4.03(1)(i) Reduktimi i shpenzimeve të projektit

Në rast se shpenzimet e përgjithshme të projektit duhet të pakësohen nga shifra e përcaktuar në pikën (2) në një nivel në të cilin shumën e kredisë kalon 50% të një shpenzimi të tillë të përgjithshëm, Banka, nëse dhe në masën që ajo nuk mund të rivendosë një maksimum të tillë përqindjeje duke anuluar një shumë proporcionale të kredisë, mund të kërkojë parapagim të një pjese të tillë të huasë, siç kërkohej për të rivendosur një maksimum të tillë, duke njoftuar Huamarrësin.

4.03(1)(ii) *Pari Passu* për shlyerjen e një huaje tjetër me afat

Nëse Huamarrësi parapaguan vullnetarisht një pjesë ose të tërën nga një hua tjetër, apo një borxh ose kredi tjetër, me një përmbajtje që mbetet, në momentin e parapagimit, për më shumë se pesë (5) vjet (këtu quhet “Huaja me afat”), ndryshe nga të ardhurat e huasë që ka një afat të paktën të barabartë me afatin e paskaduar të parapagimit të huasë, Banka, duke njoftuar Huamarrësin, mund të anulojë kredinë ose të kërkojë parapagimin e huasë në proporcion të tillë që shumën e riparuar e huasë me afat ka me shumën totale të mbetur të huave me afat.

Banka ia drejton njoftimin e saj Huamarrësit brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit, sipas nenit 8.02(ii).

4.03(2) Mekanizmi i parapagimit

Çdo shumë që kërkohej nga Banka në pajtim me nenin 4.03(1), së bashku me çdo interes të akumuluar, paguhet në datën e treguar nga Banka, datë e cila nuk është më pak se tridhjetë (30) ditë nga data e njoftimit të Bankës për kërkesën.

Nëse, për më tepër, Huamarrësi parapaguan një transh në datën e ndryshme nga data përkatëse e pagimit, Huamarrësi kompenzon Bankën në shumën të tillë që Banka vërteton se duhet për të kompensuar për marrjen e fondeve në një datë të ndryshme nga data e pagimit.

4.03(3) Kërkesa për parapagesa të pjesshme

Nëse Huamarrësi parapaguan pjesërisht një transh, shumën e parapagimit zbatohet për normë ose

sipas zgjedhjes së tij, me rend të anasjellë të maturitetit të çdo kësti të mbetur.

Nëse Banka kërkon një parapagim të pjesshëm të huasë, Huamarrësi, në përmbushje të kërkesës, duke njoftuar Bankën, brenda pesë (5) ditëve pune të Luksemburgut për marrjen e kërkesës së Bankës, mund të zgjedhë transhet që duhen parapaguar dhe e ushtron këtë opsion për zbatimin e shumave të pjesshme.

Ky nen nuk cenon nenin 10.

Neni 5 **Pagesat**

5.01 Përcaktimi i datës së pagesës

Në këtë kontratë, “Data e pagesës” nënkupton:

i) për një transh me normë fikse, datat gjashtëmujore të specifikuar në njoftimin e disbursimit çdo vit; dhe

ii) për një transh FSFR-je, datat që hyjnë në intervalet gjashtëmujore, nga data e planifikuar e disbursimit deri në datën e maturitetit, përveç rastit kur kjo datë nuk është ditë përkatëse pune, nënkupton:

iii) për një transh me normë fikse, ditën e ardhshme përkatëse të punës, pa përshtatje ndaj interesit të pagueshëm sipas nenit 3.01;

iv) për një transh FSFR-je, ditën pasuese, nëse ka, të atij muaji kalendarik, që është ditë përkatëse pune ose në pamundësi të kësaj, ditën më të afërt paraprirëse që është ditë përkatëse pune, me përshtatje që i korrespondon interesit të pagueshëm, sipas nenit 3.01; dhe

“Ditë përkatëse pune” nënkupton:

i) për euro, një ditë në të cilën operon sistemi i pagesës mbi transferimin e shpejtë automatik në kohë reale të shlyerjes bruto (Target); dhe

ii) për çdo monedhë tjetër, një ditë në të cilën bankat janë të hapura për gjendje normale pune në qendrën e brendshme kryesore të monedhës përkatëse.

5.02 Marrëveshja e numërimit të ditëve

Çdo shumë e pagueshme me anë të interesit, dëmshpërblimit ose tarifës nga Huamarrësi, sipas kësaj kontrate, dhe e llogaritur në lidhje me një ndarje të një viti, do të përcaktohet në marrëveshjet e mëposhtme:

i) për një transh me normë fikse, një vit prej treqind e gjashtëdhjetë (360) ditësh dhe një muaj prej tridhjetë (30) ditësh; dhe

ii) për një transh FSFR-je, një vit prej treqind e gjashtëdhjetë (360) ditësh, (por treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë (e pandryshueshme) për GBP) dhe numrin e ditëve të kaluara.

5.03 Koha dhe vendi i pagesës

Shumat që s’janë shuma interesi, të dëmshpërblimit dhe principalit, janë të pagueshme brenda shtatë (7) ditëve nga marrja e kërkesës së Bankës nga Huamarrësi.

Çdo shumë e pagueshme nga Huamarrësi, në bazë të kësaj kontrate, paguhet në llogarinë përkatëse, e cila i njoftohet Huamarrësit nga Banka. Banka e tregon llogarinë jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së mbarimit të afatit për pagesën e parë nga Huamarrësi dhe njofton për çdo ndryshim llogarie jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së pagesës së parë, e cila ka pësuar ndryshimin. Kjo periudhë njoftimi nuk vlen në rastin e pagesës në bazë të nenit 10.

Shuma për t’u paguar nga Huamarrësi konsiderohet e paguar në momentin e marrjes së kësaj shume nga Banka.

Neni 6 **Zotimet**

6.01 Përdorimi i huasë dhe fonde të tjera të disponueshme

Financuesi i përdor fitimet e nxjerra nga huaja vetëm për zbatimin e projektit.

Financuesi merr masa të sigurojë që Përfituesi të ketë në dispozicionin e tij fondet e tjera të renditura në të dhënat faktike (2) dhe që fonde të tilla të përdoren, në masën e kërkuar, për financimin e projektit.

6.02 Zbatimi dhe përfundimi i projektit

Financuesi dhe Përfituesi i nxitur prej tij realizojnë projektin, në përputhje me përshkrimin teknik, me ndryshimet e reflektuara që mund të bëhen herë pas here me miratimin e Bankës dhe e përfundojnë atë në afatin e caktuar aty.

Financuesi e shtyn Përfituesin që llogaritë e tij t’i nënshtrohen auditimit të përvitshëm, duke u

bazuar në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit duke filluar nga viti 2006 në vazhdim.

Financuesi njofton dhe konsultohet rregullisht me Bankën, lidhur me hartimin e masterplanit të përditësuar për portin e Durrësit dhe privatizimin e mundshëm të disa shërbimeve që ofrohen nga Përfituesi.

6.03 Kostoja shtesë e projektit

Në rast se kostoja e përgjithshme e projektit e kalon shifrën e llogaritur që jepet në të dhënat faktike (2), Huamarrësi dhe/ose Financuesi e sigurojnë financimin për të mbuluar koston shtesë pa qenë nevoja t'i drejtohen Bankës, në mënyrë që të sigurohen që projekti të përfundojë në përputhje me përshkrimin teknik. Planet e Huamarrësit dhe/ose të Financuesit për financimin e koston shtesë i paraqiten në kohë Bankës për miratim.

6.04 Procedura e prokurimeve

Financuesi i garanton Bankës dhe merr përsipër që të gjitha punimet, mallrat dhe shërbimet për projektin janë porositur dhe do të porositen, blihen dhe sigurohen me tender të hapur ndërkombëtar ose procedura të tjera të pranueshme prokurimi, në pajtim me politikën e saj, siç përshkruhet në udhëzuesin e saj të prokurimit e që hyn në fuqi datën që lidhet kjo kontratë, ashtu siç e kërkon Banka.

6.05 Zotimet e vazhdueshme të projektit

Për sa kohë që huaja nuk është kthyer, Financuesi dhe Përfituesi i nxitur prej tij, sipas rastit:

i) Mirëmbajtja: mirëmbajnë, riparojnë, bëjnë kontrolle dhe zëvendësojnë me të reja të gjitha punimet dhe objektet në pronësi, që janë pjesë përbërëse e projektit, siç kërkohet për ta mbajtur në gjendje të mirë pune dhe sigurojnë fonde të mjaftueshme për qëllimet e përmendura;

ii) Asetet e projektit: në qoftë se Banka nuk e ka dhënë miratimin e saj paraprak me shkrim, kanë të drejtë pronësie dhe zotërojnë të gjitha ose thuajse të gjitha asetet që përbëjnë projektin ose, aty ku shihet e arsyeshme, zëvendësojnë dhe përtërijnë mjete të tilla dhe mbajnë projektin në punë të vazhdueshme në përputhje me qëllimin e tij fillestar; me kusht që Banka mund të mos e japë pëlqimin vetëm ku veprimi i propozuar do të cenonte interesat e Bankës si huadhënëse për Huamarrësin ose do ta bënte projektin të papranueshëm për financim nga Banka, në bazë të statutit apo nenit 267 të Traktatit të Romës;

iii) Sigurimi: sigurojnë të gjitha punimet dhe pasuria që është pjesë përbërëse e projektit të shoqëritë më të mira të sigurimit, në përputhje me praktikën më gjithëpërfshirëse përkatëse të industrisë;

iv) Të drejtat dhe lejet: mbajnë në fuqi të gjitha të drejtat për kalim apo përdorimin dhe të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin dhe funksionimin e projektit;

v) Mjedisi: zbatojnë dhe realizojnë projektin në përputhje me ato ligje të Bashkimit Europian, në masën që zbatohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë ose të përcaktuara nga Banka para datës së kësaj kontrate, si edhe traktate të zbatueshme ndërkombëtare, nga të cilat objektivi kryesor është ruajtja, mbrojtja apo përmirësimi i mjedisit; për këtë qëllim “Mjedisi” nënkupton si vijon: (a) kushtet ku jetojnë njerëzit; (b) fauna dhe flora; (c) toka, uji, ajri, klima dhe peizazhet; dhe (d) trashëgimia kulturore dhe mjedisi i ndërtuar nga dora e njeriut; dhe përfshin kushtet e punës së punëtorëve të punësuar në këtë projekt dhe efektet e tij shoqërore; dhe

vi) Ligji i përgjithshëm: ekzekutojnë dhe zbatojnë projektin me qëllim që të veprohet në përputhje me parimet e ligjit të BE-së, që është drejtpërdrejt i zbatueshëm të Financuesi dhe projekti, siç zbatohet nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.

6.06 Njësia e zbatimit të projekteve

Financuesi mban NJZP-në ekzistuese ose një organizatë tjetër me funksion të njëjtë të pranueshëm nga Banka, me një nivel të mjaftueshëm të punësimit të një personeli kompetent dhe e përforcon atë, sipas nevojës, me konsulentë me përvojë.

6.07 Angazhimi për integritet

Huamarrësi dhe Financuesi, garantojnë dhe marrin përsipër se as ata dhe asnjë individ për sa janë në dijeni, nuk ka kryer asnjë nga veprimet e mëposhtme dhe se as ata e asnjë individ tjetër, me pëlqimin apo me dijeninë e tyre, nuk do të kryejnë akte të tilla si vijojnë:

i) ofrim, dhënie, marrje apo kërkesë për favorizim të pandershëm për të ndikuar në veprimin e personave që kanë një post a funksion zyrtar ose të një drejtori apo nëpunësi të një autoriteti publik apo ndërmarrjeje publike, ose një drejtori apo zyrtari të një organizate publike ndërkombëtare, në lidhje me procesin e prokurimit ose në zbatimin e kontratave në lidhje me ato elemente të projektit që përshkruhen në përshkrimin teknik; ose

ii) veprime që ndikojnë pandershmërisht ose synojnë pandershmërisht të ndikojnë në procesin e prokurimit apo në zbatimin e projektit në dëm të Huamarrësit dhe/ose Financuesit, përfshirë marrëveshjet e

fshehta të pandershme mes tenderuesve.

Për këtë qëllim, informacioni që disponon një ministër, zëvendësministri, ndihmësministri, këshilltar ministri, drejtuesi ose pjesëtari i personelit të NJZP-së konsiderohet si informacion që e disponon edhe Huamarrësi apo Financuesi. Huamarrësi dhe Financuesi marrin përsipër ta njoftojnë Bankën në rast se janë në dijeni për fakte apo të dhëna që sugjerojnë se janë kryer veprime të tilla.

Neni 7 **Pari Passu**

Nëse Huamarrësi më tej i ofron garanci një pale të tretë për shlyerjen e detyrimeve të jashtme të tij apo favorizon a jep prioritet në lidhje me të, Huamarrësi njofton Bankën dhe, nëse këtë ia kërkon Banka, i ofron Bankës siguri/garanci të njëjtë për shlyerjen e detyrimeve të tij, siç parashikohet nga ky dokument, ose favorizon apo i jep prioritet të njëjtë Bankës. Huamarrësi pohon se aktualisht nuk ekziston një garanci/siguri, favorizim a prioritet i tillë.

Asgjë nga paragrafi i mësipërm nuk është i zbatueshëm: (i) për garancitë e pagesës së shitësit ose garancive të tjera mbi tokën dhe asetet të tjera, ku garanci të tilla sigurojnë vetëm çmimin e blerjes apo kredi, me një afat jo më shumë se dymbëdhjetë (12) muaj, e fituar për financimin e tij ose për (ii) lënien peng të aksioneve të krijuara për të siguruar kredi afatshkurtra.

Neni 8 **Informacione dhe vizita**

8.01 Informacione në lidhje me projektin

Financuesi:

i) i dorëzon Bankës (a) informacionin në përmbajtje dhe formë dhe në periudhat kohore të përcaktuara në shtojcën A.2 ose përndryshe siç është rënë dakord herë pas here nga palët nënshkruese të kësaj kontrate; dhe (b) informacione të tilla apo dokumente të tjera në lidhje me financimin, prokurimin, zbatimin, vënien në funksionim dhe efektin mbi mjedisin e ose për projektin siç mund ta kërkojë Banka;

ii) paraqet për miratim nga Banka pa vonesë çdo ndryshim material në çmim, projekt, plane, afatin kohor apo programin e shpenzimeve për projektin, në lidhje me dhënien e informacionit të nxjerrë Bankës përpara nënshkrimit të kësaj kontrate;

iii) i jep Bankës, nëse një gjë e tillë kërkohet, (a) një dëshmi të siguruesve të tij ku tregohet plotësimi i kërkesave të nenit 6.05 (iii) dhe (b) çdo vit, një listë me policat në fuqi që mbulojnë pronën e siguruar që është pjesë përbërëse e projektit, së bashku me konfirmimin e pagesës së primeve aktuale;

iv) njofton menjëherë Bankën lidhur me (a) çështje gjyqësore të rëndësishme që kanë filluar apo i kanosen për sa i përket çështjeve të mjedisit apo të tjera që prekin projektin; ose (b) fakte apo ngjarje për të cilat ka dijeni Financuesi, të cilat mund të cenojnë në mënyrë të konsiderueshme apo të prekin kushtet e zbatimit apo funksionimit të projektit;

v) duke filluar nga viti 2007, i paraqet çdo vit Bankës llogaritë e Përfituesit të audituar mbi bazën e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, duke filluar nga viti 2006.

8.02 Informacione në lidhje me Huamarrësin

Huamarrësi njofton Bankën për sa më poshtë:

i) menjëherë lidhur me qëllimet nga ana e tij për të krijuar interesa sigurimi nga asetet e tij në favor të një pale të tretë dhe/ose ngjarje që mund ta pengojnë Huamarrësin të përmbushë detyrimet e tij, në bazë të nenit 7;

ii) vendimet që merr për të bërë një parapagesë të një huaje me afat;

iii) menjëherë, lidhur me fakte që e detyrojnë atë dhe me kërkesa që i bëhen atij ose për të parapaguar për shkak mospërmbushjeje detyrimi, plotësisht ose pjesërisht, me huatë që i jepen nga një palë e tretë ose të shlyejë për një arsye të tillë përpara maturimit borxhet/detyrimet financiare që rrjedhin nga transaksione financiare apo pjesë të tyre; dhe

iv) përgjithësisht lidhur me çdo fakt apo ngjarje që mund ta pengojë përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit dhe/ose Financuesit në bazë të kësaj kontrate.

8.03 Vizita nga Banka

Për sa kohë që huaja nuk është shlyer, Huamarrësi dhe Financuesi marrin masa që personat e caktuar nga Banka, të cilët mund të shoqërohen nga përfaqësues të Gjykatës së Audituesve të Komuniteteve Europiane, të lejohen të bëjnë vizita në kantiere/terrene dhe të kryejnë kontrolle që kanë

dëshirë. Për këtë qëllim Huamarrësi dhe Financuesi u ofrojnë këtyre personave dhe përfaqësuesve ose merr masa që t'u jepet gjithë ndihma e nevojshme.

8.04 Hetimet dhe informacionet

Huamarrësi dhe Financuesi marrin përsipër:

i) të ndërmarrin veprimet që i kërkon Banka për të hetuar dhe/ose ndërpresë akte të supozuara apo dyshuara të natyrës që përshkruhet në nenin 6.07;

ii) të njoftojë Bankën lidhur me masat e marra për të kërkuar dëmshpërblim nga personat përgjegjës për humbjet e shkaktuara nga aktet të tilla; dhe

iii) të lehtësojë hetimet që mund të bëjë Banka në lidhje me akte të tilla.

Në rast se Huamarrësi nuk e specifikon ndryshe me shkrim drejtuar Bankës, Huamarrësi është përgjegjës për kontaktet me Bankën për qëllime të nenit 6.07.

Neni 9

Detyrimet për t'u paguar dhe shpenzimet

9.01 Taksat, tatimet dhe tarifat

Huamarrësi paguan të gjitha taksat, tatimet, tarifat dhe detyrimet e tjera të çfarëdolloj natyre qofshin, përfshirë taksën për vulën dhe tarifat e regjistrimit, që janë pasojë e realizimit apo zbatimit të kësaj kontrate apo dokumenteve të tjera të lidhura me këtë dhe në krijimin e garancive për huanë në masën që është e zbatueshme.

Huamarrësi paguan të gjithë principalin, interesat, dëmshpërblimin dhe shuma të tjera që janë për t'u paguar, në bazë të kësaj kontrate bruto pa asnjë zbritje të taksave kombëtare apo lokale; me kusht që, në qoftë se Huamarrësi është i detyruar të bëjë një zbritje të tillë, do t'ia shtojë këtë zbritje/taksë pagesës bërë për Bankën në mënyrë që pas zbritjes, shuma neto që merr Banka të jetë e njëjtë me shumën që duhet paguar.

9.02 Detyrime të tjera

Huamarrësi mbulon të gjitha shpenzimet, përfshirë tarifat profesionale, komisionet bankare apo komisionet e këmbimit valutor që rrjedhin në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate apo dokumenteve që kanë lidhje me të, përfshirë ndryshimet në të, dhe në krijimin, administrimin dhe realizimin e çdo lloji sigurie/garancie për huanë, nëse ka, si edhe shpenzime të Bankës në bazë të nenit 8.03.

Banka siguron mbështetje me dokumente për pagesa të tilla apo shpenzime shtatë (7) ditë përpara se kërkesës për pagesë t'i vijë afati i shlyerjes.

Neni 10

Parapagesa në rast mospërmbushjeje detyrimi

10.01 E drejta për të kërkuar parapagesë

Huamarrësi e kthen huanë ose pjesë të saj menjëherë, së bashku me interesin e shtuar, me të marrë kërkesën me shkrim nga Banka, në përputhje me dispozitat e mëposhtme.

10.01(1) Kërkesa e menjëhershme

Banka mund ta bëjë një kërkesë të tillë menjëherë:

i) Në qoftë se Huamarrësi nuk arrin të kthejë në afat pjesë të huasë, të paguajë interes mbi të ose t'i bëjë Bankës pagesa të tjera siç parashikohet në këtë dokument;

ii) Në qoftë se Huamarrësi nuk arrin të shlyejë detyrimet financiare në lidhje me hua të tjera, (përveç huasë) që i janë dhënë nga Banka dhe në qoftë se pas mospërmbushjes së detyrimeve në lidhje me këtë, Huamarrësit i kërkohet të parapaguajë huatë e tjera ose të shlyejë përpara maturimit detyrimet që janë pasojë e një transaksioni financiar;

iii) Në qoftë se, pas mospërmbushjes nga ana e Huamarrësit dhe/ose Financuesit të detyrimeve për sa i përket huave që referohen në të dhënat faktike (2) ose grante dhënë nga Bashkimi Europian, e drejta e Huamarrësit dhe/ose Financuesit për të përdorur të ardhurat nga ajo hua ose grante të tilla, plotësisht ose pjesërisht, janë anuluar apo ndërprerë, ose në qoftë se ajo hua apo grant i tillë është bërë i shlyeshëm sipas kushteve të tij;

iv) Në qoftë se informacionet ose dokumentet e dhëna Bankës nga ose në emër të Huamarrësit ose Financuesit në lidhje me bisedimet për këtë kontratë, ose gjatë kohëzgjatjes së saj vërtetohet se ka qenë e pasaktë në mënyrë të veçantë në materiale; ose

v) Në përgjithësi, në qoftë se një ngjarje apo situatë ndodh që ka mundësi të rrezikojë pagesën e

interesit mbi huanë, ose të ndikojë negativisht në sigurinë/garancinë për atë qëllim.

10.01(2) Kërkesa pas njoftimit për dëmshpërblim

Banka mund ta bëjë një kërkesë të tillë për çështjen që nuk po zgjidhet brenda një periudhe të arsyeshme kohe e përcaktuar në një njoftim për huamarrësit nga Banka:

i) Në qoftë se Huamarrësi dhe/ose Financuesi nuk arrin të përmbushë detyrimet materiale në bazë të kësaj kontrate duke mos qenë detyrim i përmendur në nenin 10.01(1)(i);

ii) Në qoftë se faktet që përmenden në të dhënat faktike ndryshohen materialisht dhe nuk kthehen materialisht dhe në qoftë se ndryshimi ose cenon interesat e Bankës si huadhënëse në raport me Huamarrësin ose ndikon negativisht në zbatimin apo funksionimin e projektit; ose

iii) Në qoftë se ka shkelje të detyrimeve që ka Huamarrësi dhe/ose Financuesi sipas neneve 6, 7 ose 8 të kësaj kontrate, përveç parashtrimit të gabuar të fakteve parashikuar në nenin 10.01(1)(iv).

10.02 Të drejta të tjera me ligj

Neni 10.01 nuk kufizon të drejta të tjera të Bankës që i jep ligji për të kërkuar parapagesën e huasë.

10.03 Dëmshpërblimi

10.03(1) Transhe me normë fikse

Në rast kërkesë, sipas nenit 10.01, në lidhje me normën fikse, Huamarrësi i paguan Bankës shumën e kërkuar së bashku me një shumë të llogaritur në përputhje me nenin 4.02(2)(i) për çdo shumë që i ka ardhur koha të paguhet. Një shumë e tillë do të rritet nga afati i pagesës e specifikuar kjo në njoftimin e Bankës për kërkesën dhe do të llogaritet mbi bazën që parapagesa hyn në fuqi datën e caktuar.

10.03(2) Transhe FSFR

Në rast kërkesë sipas nenit 10.01 në lidhje me një transh FSFR-je, Huamarrësi i paguan Bankës shumën e kërkuar së bashku me një shumë të barabartë me vlerën aktuale të 0.15% (15 pika baze=.01%) në vit të llogaritur dhe mbledhur nga shuma që është për t'u parapaguar në të njëjtën mënyrë si do të ishte llogaritur e shtuar interesi, në qoftë se ajo shumë do të kishte mbetur e pashlyer sipas programit fillestar të shlyerjes së transhit.

Një vlerë e tillë aktuale do të përcaktohet duke përdorur një normë uljeje, zbatuar duke nisur nga secila datë përkatëse për pagesën. Norma e uljes është norma fikse e zbatueshme një (1) muaj përpara datës së parapagesës me të njëjtat mënyra/kushte pagesë të interesit dhe të njëjtin afat për datën e maturimit.

10.03(3) Të përgjithshme

Shumat që duhet të paguhën nga Huamarrësi, sipas këtij neni 10.03, janë të pagueshme ditën e parapagesës përcaktuar në kërkesën e Bankës.

10.04 Mosheqje dorë nga një e drejtë

Asnjë mungesë ushtrimi të drejte apo vonese nga ana e Bankës në ushtrimin e të drejtave të saj, në bazë të nenit 10, nuk interpretohet si heqje dorë nga një e drejtë e tillë.

10.05 Vënia në përdorim e shumave të marra

Shumat e marra nga Banka pas kërkesës së bërë në bazë të nenit 10.01 përdoren së pari për pagesën e shpenzimeve (nëse ka), interesit dhe dëmshpërblimeve dhe së dyti për pakësimin e kësteve të pashlyera në rend të anasjellë maturimi. Banka mund t'i përdorë shumat e marra mes transheve si të dojë.

Neni 11

Gjuha, ligji dhe juridiksioni

11.01 Gjuha

Çdo dokument, njoftim apo komunikim i kryer mes palëve të parashikuara në këtë kontratë bëhet në gjuhën angleze ose do të shoqërohet me një përkthim zyrtar në anglisht.

11.02 Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë i nënshtrohet ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut.

11.03 Juridiksioni

Mosmarrëveshjet, si rezultat i kësaj kontrate, i referohen Gjykatës së Komuniteteve Europiane.

Palët pjesëmarrëse në këtë kontratë, si pasojë, heqin dorë nga imuniteti apo e drejta për të kundërshtuar juridiksionin e asaj Gjykate. Çdo vendim gjykate, i dhënë në bazë të nenit 11.03, është përfundimtar dhe detyrues me ligj për palët, pa kufizime apo rezerva.

11.04 Prova për shumat që duhen paguar

Në çdo padi që ngrihet si pasojë e kësaj kontrate dëshmia e Bankës për sa i përket shumës që i detyrohet Bankës në bazë të kësaj kontrate është provë *prima facie* e një shume të tillë.

Neni 12
Dispozitat përfundimtare

12.01 Njoftimet drejtuar secilës palë

Njoftimet dhe komunikimet e tjera, të parashikuara në këtë kontratë, drejtuar secilës palë nënshkruese të kësaj kontrate bëhen me shkrim dhe dërgohen në adresën e secilës, të dhënë më poshtë ose në adresë tjetër që ia njofton tjetrit me shkrim më parë:

Për Bankën	100 Boulevard Konrad Adenauer L-2950 Luxembourg
Për Huamarrësin	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” n°1 Tirana Albania Fax.: +355 4 25 84 35>
Për Financuesin	Blvd. Dëshmorët e Kombit, nr.5 Tirana Albania
Për Përfituesin	Lagja nr. 1, Rruga Tregtare Durrës Albania

12.02 Mënyra e njoftimit

Njoftimet dhe komunikimet e tjera, për të cilat janë vendosur periudha fikse në këtë kontratë ose që vetë caktojnë periudha kohe detyruese me ligj për të adresuarin, bëhen me dorëzim në dorë, letër rekomande, faks ose mënyra të tjera transmetimi që ofron provë që e ke marrë nga i adresuari. Data e regjistrimit ose, në varësi të rastit, data e shprehur e marrjes së transmetimit është përfundimtare për llogaritjen/përcaktimin e një periudhe.

Njoftimet e nxjerra nga Huamarrësi dhe/ose Financuesi, në bazë të dispozitave të kësaj kontrate, kur kërkohet nga Banka, i dërgohen/dorëzohen Bankës së bashku me prova të pranueshme të autoritetit të personit apo personave të autorizuar për të nënshkruar një njoftim të tillë në emër të Huamarrësit dhe/ose financuesit dhe firmën e vërtetuar origjinale të një personi a personave të tillë.

12.03 Të dhënat faktike dhe shtojcat

Të dhënat faktike dhe shtojcat e mëposhtme janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate:

Shtojca A.1	Përshkrimi teknik
Shtojca A.2	Informacion mbi projektin për t’iu dërguar Bankës dhe metoda e transmetimit
Shtojca B	Përkufizimi i EURIBOR dhe LIBOR
Shtojca C	Formular për kërkesën e disbursimit

Në dëshmi të kësaj, palët pjesëmarrëse kanë nënshkruar këtë kontratë në çdo faqe në emër të tyre dhe e kanë hartuar atë në katër (4) kopje në gjuhën angleze si më poshtë.

Tiranë, 27 dhjetor 2006

Nënshkruar për dhe në emër të Republikës së Shqipërisë	Nënshkruar për dhe në emër të Bankës Europiane të Investimeve
Kryeministri	Drejtori i Asociuar Shefi i Divizionit
.....	
Prof. Dr. S. Berisha	M. Tonci Ottieri R. Massa Bernucci

PROGRAMI A

A.1 PËRSHKRIM TEKNIK
A.1.1 Qëllimi, vendndodhja

Projekti ka lidhje me planifikimin, mbikëqyrjen dhe punimet për ndërtimin e një terminali të ri tragetesh dhe punimeve ndihmëse në vend të terminalit ekzistues të trageteve në portin e Durrësit dhe duke përfshirë asistencën teknike për njësinë e zbatimit të projektit.

A.1.2 Përshkrimi

a) Ndërtimi i një terminali tragetesh për pasagjerët dhe rehabilitimi i infrastrukturës shoqëruese, sigurimi i elementeve të sigurisë për anijet e transportit midis dy brigjeve, duke përfshirë:

- Ndërtesat e terminalit; punimet e ndërtimit përfshijnë:
- një ndërtesë terminali (1 dyshe + çati);
- një kalim mbitokësor që lidh ndërtesën e terminalit dhe stacionin hekurudhor më të afërt;
- një mjedis inspektimi doganor (1 dyshe + çati), që përbëhet nga zyra përkatëse, mjediset e ngrënies dhe një tendë;
- një ndërtesë për pritjen e shoferëve (1 dyshe), që përbëhet prej një kantine dhe mjediseve të ngrënies;

- tena për kabinat e hyrjes dhe daljes.
- Zonat e rrugëve dhe parkingut; punimet e rregullimit të sirenës përfshijnë:
- shkatërrimin e të gjitha strukturave ekzistuese brenda kufijve të sirenës;
- një trotuar betoni dhe rrugë hyrëse;
- një seksion të ri të rrugës së portit ekzistues;
- ndriçimin e oborrit dhe rrugës;
- kabinat e daljes dhe hyrjes;
- platforma peshimi të ngarkesave;
- nënstacione terminali dhe gjeneratorë mbështetës;
- drenim rruge dhe sirene;
- gardh dhe porta sigurie;
- grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të zeza/të ndotura.

b) Rehabilitimi i pjesshëm i moleve 7 & 8, që përfshin:

- eliminimin e pjesëve të zbrazëta nën mole;
- shtrime të reja ballore;
- rrjete inxhinierike, ndriçim, drenim dhe shtrim me beton;
- diseno të mundshme dhe/ose mbikëqyrje të komponentëve të projektit.

c) Punime ndihmëse, që përfshijnë:

- sigurimin e rrugës hyrëse në terminalin e trageteve;
- përshtatjen e kanalit të hyrjes dhe pastrimin e basenit;
- aktivitete të tjera investuese, që përfshijnë punime dhe shtrimin e trasesë, punime hekurudhore dhe elektrike etj, në lidhje me ngritjen e zonave të moleve 10 & 11, me qëllim transferimin e operacioneve të ngarkesave në molet lindore;
- disenjon e mundshme dhe/ose mbikëqyrjen e komponentëve të projektit.

d) Aktivitete të tjera investuese siç mund të përcaktohen gjatë planifikimit të detajuar të projektit dhe që i nënshtrohen buxhetit të mbetur, si dhe zërave të ndryshëm specifikë ndaj bankës si shërbime në lidhje me këto aktivitete.

A.1.3 Asistenca teknike

Asistenca teknike (AT) për njësinë e zbatimit të projektit, për menaxhimin e projektit: kjo përfshin analizën dhe justifikimin e punimeve, asistencën në procedurat monitoruese mjedisore, rishikimin e disenjës (nëse është e nevojshme) dhe të dokumenteve të tenderit, asistencën në vlerësimin e tenderit, kontrollin e cilësisë së punimeve dhe asistencën për kontratën e konsulencës mbikëqyrëse.

A.1.4 Kalendar

Disenjoja e detajuar është përgatitur gjatë periudhës 2002-2004 nga një konsulent ndërkombëtar; përgatitja përfundimtare e dokumenteve të tenderit do të ndërmerret afërsisht nga mesi i vitit 2006 dhe fillimi i vitit 2007. Lidhja e kontratave të punimeve planifikohet për në fillim të vitit 2007, me përfundim të pritshëm në fillim të vitit 2011.

Rehabilitimi i moleve 10 & 11 dhe transferimi i operacioneve të ngarkesave të portit po kryhet gjatë vitit 2006.

A.1.5 Kostot e investimeve dhe skema e financimit

Përshkrimi	EUR	Përqindja e kostove bazë	Skema e financimit			
			EIB	EBRD	CARDS/	Shqipëria

					PHARE	
Përvetësimi i tokës	nil					
Dizenjoja dhe mbikëqyrja	2.12	5.50%			100%	
Terminali i trageteve	20.12	52.70%	50%	50%		
Zëra ndihmës dhe rehabilitimi i moleve 7&8	14.37	37.60%	42%	19%		39%
Kontingjenca fizike	1.54	4.2%	52.5%	40.8%	3.3%	3.4%
Kosto bazë	38.15	100%				
Kontingjencat e çmimit	1.85	5.50%	53.8%	41.7%		4.5%
TVSH	-					
Kostoja e investimeve totale (M EUR)	40.00	105.50%	18.0	14.0	2.2	5.8

A.2 INFORMACION NË LIDHJE ME PROJEKTIN QË I DUHET DËRGUAR BANKËS DHE METODA E TRANSMETIMIT

1. Dërgimi i informacionit: caktimi i personit përgjegjës
Informacioni i mëposhtëm i duhet dërguar Bankës sipas përgjegjësisë së:

Firma	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Njësia e Zbatimit të Projektit EIB
Personi i kontaktit	Osman Metalla
Pozicioni	Drejtor
Funksioni /drejtoria	Drejtoria e Çështjeve Detare
Adresa	Bul. Dëshmorët e Kombit, Tirana, Albania
Tel	+355 (04) 256098
Faks	+355 (04) 256098
Email	metalla_os@yahoo.com

Personi/personat e mësipërm të kontaktit janë përgjegjës për periudhën në vazhdim.
Huamarrësi informon menjëherë EIB-në në rast të ndonjë ndryshimi.

2. Informacion mbi çështje specifike

Huamarrësi i dorëzon Bankës informacionin e mëposhtëm në afatin maksimal të përcaktuar më poshtë:

Dokumenti / informacioni	Afati
Miratime për leje ndërtimi dhe miratim zhvillimi, dokumentet e tenderit	Jo më vonë se 1 muaj para fillimit të procedurave përkatëse të tenderit.
Plani i menaxhimit mjedisor	Jo më vonë se 1 muaj para fillimit të punimeve përkatëse.
Raporte të veçanta në rast të situatave ose ngjarjeve të paparashikuara që mund të shkaktojnë ndërprerjen e punimeve ose kontratave të shërbimit.	Jo më vonë se 1 muaj pas shfaqjes së situatës ose ngjarjes së paparashikuar.

3. Informacion në lidhje me zbatimin e projektit

Huamarrësi i dorëzon Bankës informacionin e mëposhtëm në lidhje me ecurinë e projektit gjatë zbatimit, në afatin maksimal të përcaktuar më poshtë:

Dokumenti / informacioni	Afati	Shpeshtësia e raportimeve
--------------------------	-------	---------------------------

Raport ecurie i projektit: - Një përditësim i shkurtër mbi përshkrimin teknik, duke shpjeguar arsyet për ndryshimet thelbësore kundrejt fushës fillestare të veprimit; - Përditësim në lidhje me datën e përfundimit të secilit prej komponentëve të projektit kryesor, duke shpjeguar arsyet për çdo vonesë të mundshme; - Përditësim në lidhje me koston e projektit, duke shpjeguar arsyet për çdo rritje të kostove të mundshme kundrejt kostos fillestare të parashikuar në buxhet; - Një përshkrim të çdo çështjeje kryesore me ndikim në mjedis; - Përditësim në lidhje me procedurat e prokurimit; - Përditësim në lidhje me kërkesën e projektit ose përdorimin dhe komentet; - Çdo çështje e rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo rrezik serioz që mund të cenojë operimin e projektit; - Çdo masë ligjore në lidhje me vazhdimësinë e mundshme të projektit.	Jo më vonë se 30 ditë pas mbarimit të çdo periudhe raportuese.	Dy herë në vit
--	---	-----------------------

4. Informacion në lidhje me përfundimin e punimeve dhe vitin e parë të operimit
Huamarrësi do t'i dorëzojë Bankës informacionin e mëposhtëm mbi përfundimin e projektit dhe operimin fillestar maksimumi deri në afatin e treguar më poshtë:

Dokument / Informacion	Data e dorëzimit në Bankë
Raporti i përfundimit të projektit, që përfshin: - Një përshkrim të shkurtër të karakteristikave teknike të projektit të përfunduar, duke shpjeguar arsyet për ndonjë ndryshim të rëndësishëm; - Datën e përfundimit të secilit prej komponentëve kryesorë të projektit, duke shpjeguar arsyet për ndonjë vonesë të mundshme; - Koston përfundimtare të projektit, duke shpjeguar arsyet për ndonjë rritje të mundshme të kostos përkundërt kostos fillestare të parashikuar në buxhet; - Numrin e vendeve të reja të punës të krijuara nga projekti; të dyja vendet e punës gjatë zbatimit dhe vendet e reja të përhershme të krijuara; - Një përshkrim të çështjes kryesore me ndikim në mjedis; - Përditësim mbi procedurat e prokurimit (jashtë BE-së); - Përditësim mbi kërkesën apo përdorimin dhe komentet në lidhje me projektin; - Çdo ngjarje të rëndësishme që ka ndodhur dhe çdo rrezik serioz që mund të cenojë operimin e projektit; - Çdo veprim ligjor në lidhje me projektin që mund të jetë në proces.	Jo më vonë se 3 muaj pas përfundimit të projektit
Gjuha e raporteve	Anglisht

PËRKUFIZIMET E EURIBORIT DHE LIBORIT

PROGRAMI B

A. EURIBOR

“EURIBOR” nënkupton:

në lidhje me ndonjë periudhë përkatëse, duke përfshirë periudhën e referencës FSFR ose ndonjë periudhë tjetër kohore prej një (1) muaji ose më shumë, normën e interesit për depozitat në euro për një afat që është numri i të gjithë muajve që i korrespondon më afër kohëzgjatjes së periudhës; dhe

në lidhje me një periudhë përkatëse prej më pak se një muaj, normën e interesit për depozitat në euro për një afat prej një (1) muaji;

(periudhën për të cilën norma është marrë duke u quajtur më pas “Periudha përfaqësuese”), siç publikohet në orën 11 paradite me kohën e Brukselit ose në një kohë të mëvonshme të pranueshme për Bankën në ditën (“Dita e ricaktuar”) që përkon dy (2) ditë përkatëse biznesi para ditës së parë të periudhës përkatëse, në faqen Reuters EURIBOR 01 ose në faqen pasardhëse të saj, ose kur nuk e ka arritur këtë me ndonjë mënyrë tjetër publikimi të zgjedhur për këtë qëllim nga Banka.

Nëse kjo normë nuk publikohet në këtë mënyrë, Banka i kërkon zyrtarëve kryesorë të eurozonës, së katër bankave kryesore në eurozonë, të përzgjedhura nga Banka, të caktojnë normën në të cilën ofrohen nga secila prej tyre depozitat në Euro në një shumë të krahasueshme, rreth orës 11 paradite me kohën e Brukselit, në datën e ricaktuar ndaj bankave kryesore në tregun ndërbankar të eurozonës për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kurse, norma për atë datë të ricaktuar do të jetë mesatarja aritmetike e këtyre kurseve.

Nëse siç janë kërkuar, sigurohen më pak se dy kurse, norma për atë datë të ricaktuar do të jetë mesatarja aritmetike e normave të caktuara nga bankat kryesore në eurozonë, të përzgjedhura nga Banka rreth orës 11 paradite me kohën e Brukselit, në ditën që përkon me dy (2) ditë përkatës pune pas datës së ricaktuar, për huatë në euro në një shumë të krahasueshme për Bankat kryesore Europiane për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese.

B. LIBOR USD

“LIBOR” në lidhje me USD, nënkupton:

në lidhje me ndonjë periudhë përkatëse, duke përfshirë periudhën e referencës FSFR ose ndonjë periudhë tjetër kohore prej një (1) muaji ose më tepër, normën e interesit për depozitat për një periudhë që është numri i tërë muajve që korrespondon më afër kohëzgjatjes së periudhës; dhe

në lidhje me një periudhë përkatëse prej më pak se një muaj, normën e interesit për depozitat në USD për një periudhë prej një (1) muaji,

(periudha për të cilën bëhet norma që quhet këtu e tutje “Periudha përfaqësuese”)

siç përcaktohet nga Shoqata e Bankierëve Britanikë dhe nxirret nga agjentët e lajmeve financiare në orën 11 paradite me kohën Londineze ose në një kohë të mëvonshme, të pranueshme për Bankën në ditën (“Data e ricaktuar”), që përkon me dy (2) ditë pune Londineze para ditës së parë të periudhës përkatëse.

Nëse kjo normë nuk nxirret nga ndonjë agjent lajmesh financiare, i pranueshëm për Bankën, Banka i kërkon zyrtarëve kryesorë Londineze të katër Bankave kryesore në tregun ndërbankar londinez të përzgjedhur nga Banka, të caktojë normën në të cilën ofrohen nga secili prej tyre depozitat USD në një shumë të krahasueshme, rreth orës 11 paradite me kohën Londineze në datën e ricaktuar, ndaj bankave kryesore në tregun ndërbankar Londinez për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kurse të tilla, norma do të jetë mesatarja aritmetike e këtyre kurseve.

Nëse siç janë kërkuar, sigurohen më pak se dy kurse, Banka i kërkon zyrtarëve kryesorë të Nju- Jork-ut të katër Bankave kryesore në tregun ndërbankar të Nju Jork-ut, të përzgjedhur nga Banka, të caktojë tarifën në të cilën ofrohen nga secili prej tyre rreth orës 11 paradite me kohën e Nju-Jork-ut në ditën që përkon me dy (2) ditë pune njujorkeze pas datës së ricaktuar, ndaj bankave kryesore në tregun European për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese, depozita në USD në një sasi të krahasueshme.

C. LIBOR GBP

“LIBOR” nënkupton, në lidhje me GBP-në:

në lidhje me ndonjë periudhë përkatëse, duke përfshirë periudhën e referencës FSFR ose ndonjë periudhë tjetër kohore prej një (1) muaji ose më tepër, normën e interesit për depozitat për një periudhë që është numri i tërë muajve që korrespondon më afër kohëzgjatjes së periudhës; dhe

në lidhje me një periudhë përkatëse prej më pak se një muaj, normën e interesit për depozitat në GBP për një periudhë prej një (1) muaj,

(periudha për të cilën bëhet norma që quhet këtu e tutje “Periudha përfaqësuese”)

siç përcaktohet nga Shoqata e Bankierëve Britanikë dhe sigurohet nga agjentët e lajmeve financiare në orën 11 paradite me kohën londineze ose në një kohë të mëvonshme, të pranueshme për

Bankën në ditën (“Data e ricaktuar”) në të cilën fillon periudha përkatëse ose nëse ajo ditë nuk është një ditë pune londineze, në ditën e mëpasshme që është ditë-pune.

Nëse kjo normë nuk sigurohet nga ndonjë agjent lajmesh financiare, i pranueshëm për Bankën, Banka i kërkon zyrtarëve kryesorë londineze të katër Bankave kryesore në tregun ndërbankar londinez të përzgjedhur nga Banka të caktojë normën në të cilën ofrohen nga secili prej tyre depozitat GBP në një shumë të krahasueshme, rreth orës 11 paradite me kohën londineze në datën e ricaktuar, ndaj bankave kryesore në tregun ndërbankar londinez për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese. Nëse sigurohen të paktën dy kurse të tilla, norma do të jetë mesatarja aritmetike e këtyre kurseve.

Nëse sipas kërkesës, sigurohen më pak se dy kurse, norma do të jetë mesatarja aritmetike e normave të caktuara rreth orës 11 me kohën londineze, në datën e ricaktuar nga bankat kryesore në Londër (përzgjedhur nga Banka për huatë në GBP në një shumë të krahasueshme me atë të Bankave kryesore për një periudhë të barabartë me periudhën përfaqësuese.

D. TË PËRGJITHSHME

Për qëllime të përkufizimeve të mëposhtme:

“Ditë pune londineze”, nënkupton një ditë në të cilën bankat janë të hapura për gjendje normale pune në Londër dhe “Ditë punë njujorkeze”, nënkupton një ditë në të cilën bankat janë të hapura për gjendje pune normale në Nju Jork.

Të gjitha përqindjet që rezultojnë nga çdo llogaritje e referuar në këtë program do të rrumbullakosen, nëse është e nevojshme, me më të afërtën e njëqind të mijtës së pikës së përqindjes, me gjysma të rrumbullakosura.

Banka informon Huamarrësin pa vonesë në lidhje me kurset e marra nga Banka

Nëse ndonjë nga dispozitat e mësipërme nuk është në pajtim me dispozitat e miratuara nën kujdesin e EURIBOR FBE dhe EURIBOR ACI në lidhje me EURIBOR ose me Shoqatën Britanike të Bankierëve në lidhje me LIBOR-in, Banka me anë të një njoftimi drejtuar Huamarrësit, mund të amendojë dispozitën dhe ta sjellë atë në linjë me dispozitat e tjera.

PROGRAMI C

FORMULARI I KËRKESËS PËR DISBURSIM

Kërkesa për disbursim	Transhi nr:	Datë: ..
Ju lutem procedoni me disbursimin e mëposhtëm:		
Emri i huasë (*):	Terminali i pasagjerëve të portit të Durrësit	Rezervuar për EIB-në Sasia e huasë: EUR 18 mil Disbursuar deri tani: Bilanci për disbursim: Afati i kërkesës për disbursim: 10 dhjetor 2010 Numri maksimal i disbursimeve: 6 Numri minimal i transheve: EUR 3,000,000 Alokimet totale deri tani: Kushtet e mëparshme: Neni. 1.04
Data e nënshkrimit (*):	<27 dhjetor 2006>	
Numri i referencës:1		
Numri i disbursimit ^o :		
Data e propozuar e disbursimit:		
Kërkesa totale (monedha e kontratës):		
Për t’u disbursuar si më poshtë:		
Monedha (Neni. 1.03)		
Sasia		
Baza e normës së interesit	Norma fikse FSFR	

¹ Për pjesën hyrëse të kontratës.

Norma e interesit/ shtrirja (Neni 3.01)	
Frekuenca e interesit (Neni 3.01)	Gjashtëmujore
Shlyerja (Neni. 4.01)	Këste me kapital të barabartë/ të ardhura vjetore konstante
Datat e pagesës (Neni 5.01)	
Data e parë e shlyerjes	
Data e fundit e shlyerjes	

Llogaria e Huamarrësit që duhet të kreditohet:

Acc. N°:

Emri dhe adresa e Bankës:

Ju lutem transmetoni informacionin përkatës për kërkesë në:

Emri (emrat) e autorizuar të promovuesit dhe nënshkrimi (nënshkrimet):

LIGJ
Nr.9692, datë 8.3.2007

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
DETARE “PËR PËRGATITJEN NDAJ NDOTJES NGA NAFTA, REAGIMI DHE
BASHKËVEPRIMI (OPRC), 1990”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për përgatitjen ndaj ndotjes nga nafta, reagimi dhe bashkëveprimi (OPRC), 1990”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5239, datë 20.3.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTË NDËRKOMBËTARE
MBI PËRGATITJEN NDAJ NDOTJES NGA NAFTA, REAGIMI DHE BASHKËVEPRIMI,
1990

Palët e Kësaj Konvente,
të ndërgjegjshme për nevojën e ruajtjes së ambientit të njeriut në përgjithësi dhe ambientit detar në veçanti;

duke njohur kërcënimin serioz që përbëjnë për ambientin detar incidentet e ndotjes nga nafta, që kanë të bëjnë me anijet, njësitë detare, portet detare dhe impiantet e trajtimit të naftës;

duke ditur në radhë të parë rëndësinë e masave paraprake dhe parandalimin për mënjanimin e ndotjes nga nafta, si dhe nevojën për zbatimin rigoroz të instrumenteve ndërkombëtare ekzistuese që trajtojnë sigurinë detare dhe parandalimin e ndotjes detare, veçanërisht Konventën Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974, e ndryshuar, dhe Konventën Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, 1973, e ndryshuar me protokollin e vitit 1978 të saj, i ndryshuar, si dhe zhvillimin e shpejtë të standardeve të larta për disenjon, operimin dhe mirëmbajtjen e anijeve që mbartin naftë, dhe të njësive detare;

duke ditur gjithashtu që në rastin e një incidenti të ndotjes nga nafta, veprimi i shpejtë dhe i efektshëm është thelbësor për të minimizuar dëmin që mund të rezultojë nga një incident;

duke theksuar rëndësinë e përgatitjes së efektshme për të kundërvepruar kundrejt incidenteve të ndotjes nga nafta dhe rolin e rëndësishëm që kanë industritë e naftës dhe transportit detar në këtë aspekt;

duke njohur më tej rëndësinë e asistencës reciproke dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me çështjet që përfshijnë shkëmbimin e informacionit në varësi të mundësive të shteteve për të kundërvepruar kundrejt incidenteve të ndotjes nga nafta, përgatitjes së planeve të ndërhyrjes në rastet e ndotjes nga nafta, shkëmbimit të raporteve mbi incidentet e rëndësishme që mund të kenë ndikim mbi ambientin detar ose vijën bregdetare dhe interesat përkatëse të shteteve, dhe të kërkimit dhe zhvillimit në varësi të mjeteve të kundërveprimit ndaj ndotjes nga nafta në ambientin detar;

duke pasur parasysh parimin që “ndotësi paguan”, si një parim të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare të ambientit;

duke pasur parasysh gjithashtu edhe rëndësinë e instrumenteve ndërkombëtare mbi përgjegjësinë dhe kompensimin për dëmin nga ndotja nga nafta, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmin nga Ndotja nga Nafta të vitit 1969 (CLC), dhe Konventën Ndërkombëtare mbi Themelimin e një Fondi Ndërkombëtar për Kompensimin për Dëmin nga Ndotja nga Nafta e vitit 1971 (FUND), dhe nevojën e domosdoshme për hyrjen e parakohshme në fuqi të protokolleve të konventave të CLC-së dhe FUND-it;

po kështu, duke pasur parasysh rëndësinë e marrëveshjeve dhe masave dypalëshe dhe shumëpalëshe, duke përfshirë konventat dhe marrëveshjet rajonale;

duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit, veçanërisht pjesën e saj të XII-të;

duke ditur nevojën për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rritur mundësitë ekzistuese kombëtare, rajonale dhe globale në lidhje me përgatitjen dhe reagimin kundrejt ndotjes nga nafta, duke marrë parasysh nevojat e veçanta të vendeve në zhvillim dhe veçanërisht të shteteve të vogla të ishujve;

duke marrë parasysh që këto objektiva mund të arrihen më mirë duke përfunduar një Konventë Ndërkombëtare mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Palët, individualisht ose bashkërisht, marrin përsipër të marrin të gjitha masat e përshtatshme në pajtim me dispozitat e kësaj Konvente dhe anekset e saj për të përgatitur dhe kundërvepruar kundrejt një incidenti të ndotjes nga nafta.

2. Anekset e kësaj Konvente përbëjnë një pjesë integrale të Konventës dhe një dërgim në këtë Konventë përbën njëkohësisht një dërgim në aneks.

3. Kjo Konventë nuk zbatohet për asnjë luftanije, mjet ndihmës ose anije tjetër që është në pronësi apo operohet nga një shtet dhe përdoret, përkohësisht, vetëm si shërbim qeveritar jotregtar. Megjithatë, secila Palë siguron me anë të miratimit të masave të përshtatshme, duke mos cenuar veprimet apo aftësitë vepruese të këtyre anijeve që janë në pronësi ose operohen prej saj, që këto anije të veprojnë në një mënyrë që në masën që është e arsyeshme dhe praktike, të jetë në pajtim me këtë Konventë.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të kësaj Konvente:

1. “Nafta” është vaji mineral në çdo formë, duke përfshirë naftën bruto, mazutin, dekantimet, mbeturinat e naftës dhe produktet e rafinuara.

2. “Incident i ndotjes me naftë” është një ndodhi ose një varg ndodhish që kanë të njëjtën origjinë,

që rezultojnë ose mund të rezultojnë në derdhjen e naftës dhe që përbën ose mund të përbëjë një rrezik për ambientin detar ose për vijën bregdetare apo interesat përkatëse të një ose më shumë shteteve dhe që kërkon masa emergjence ose reagim tjetër të menjëhershëm.

3. “Anije” është një mjet lundrimi i çdo lloji, që operon në ambientin detar dhe përfshin barkat hidrofile, mjetet me jastëk ajri, mjetet zhytëse dhe mjetet pluskuese të çdo lloji.

4. “Njësi detare” është çdo instalim apo strukturë e qëndrueshme apo pluskuese detare, i përfshirë në kërkimet e gazit apo naftës, në aktivitetet e kërkimit apo prodhimit ose në ngarkimin dhe shkarkimin e naftës.

5. “Porte detare dhe mjete të trajtimit të naftës” janë ato mjete që përbëjnë një rrezik për një incident të ndotjes me naftë dhe përfshijnë, ndër të tjera, portet detare, terminalet e naftës, tubacionet dhe mjetet e tjera të trajtimit të naftës.

6. “Organizatë” është Organizata Ndërkombëtare Detare.

7. “Sekretar i Përgjithshëm” është Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës.

Neni 3

Planet e emergjencës së ndotjes nga nafta

1. a) Secila Palë kërkon që anijet që kanë të drejtë të mbajnë flamurin e saj, të kenë në bord një plan emergjence për ndotjen nga nafta sipas kërkesave dhe në pajtim me dispozitat e miratuara nga Organizata për këtë qëllim.

b) Një anije, së cilës i kërkohet të ketë në bord një plan emergjence për ndotjen nga nafta në pajtim me nënparagrafin (a), gjatë qëndrimit në një port ose në një terminal detar nën juridiksionin e një Pale, i nënshtrohet inspektimit të nëpunësve të autorizuar rregullisht nga ajo Palë, në pajtim me praktikën e parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare ekzistuese ose legjislationin e saj kombëtar.

2. Secila Palë kërkon që operatorët e njësive detare nën juridiksionin e saj të kenë plane emergjence për ndotjen nga nafta, që janë të bashkërenduara me sistemin kombëtar të ngritur në pajtim me nenin 6 dhe të aprovuar në pajtim me procedurat e caktuara nga autoriteti kompetent i brendshëm.

3. Secila Palë kërkon që autoritetet ose operatorët në ngarkim të këtyre porteve detare dhe mjeteve të trajtimit të naftës nën juridiksionin e saj, që ajo i mendon të arsyeshme, të kenë plane emergjence të ndotjes nga nafta ose masa të ngjashme që janë të bashkërenduara me sistemin e brendshëm të ngritur në pajtim me nenin 6 dhe të aprovuar në pajtim me procedurat e caktuara nga autoriteti i brendshëm kompetent.

Neni 4

Procedurat e raportimit të ndotjes nga nafta

1. Secila Palë:

a) u kërkon kapitenëve ose personave të tjerë në ngarkim të anijeve që mbajnë flamurin e saj dhe personave në ngarkim të njësive detare nën juridiksionin e saj, të raportojnë pa vonesë çdo ngjarje në anijen e tyre ose njësinë detare që ka të bëjë me derdhjen ose derdhjen e mundshme të naftës:

i) në rastin e një anijeje, shtetit më të afërt bregdetar;

ii) në rastin e një njësie detare, shtetit bregdetar, juridiksionit të të cilit i nënshtrohet njësia.

b) u kërkon kapitenëve ose personave të tjerë në ngarkim të anijeve që kanë flamurin e saj dhe personave në ngarkim të njësive detare nën juridiksionin e saj, të raportojnë pa vonesë çdo ngjarje të vëzhguar që ka të bëjë me derdhjen e naftës ose praninë e naftës:

i) në rastin e një anijeje, shtetit më të afërt bregdetar;

ii) në rastin e një njësie detare, shtetit bregdetar, juridiksionit të të cilit i nënshtrohet njësia.

c) u kërkon personave që kanë në ngarkim portet detare dhe mjetet e trajtimit të naftës, nën juridiksionin e tij të raportojnë pa vonesë çdo ngjarje që ka të bëjë me një derdhje ose një derdhje të mundshme të naftës ose praninë e naftës autoritetit kompetent të brendshëm;

d) udhëzon mjetet e lundrimit ose të fluturimit të inspektimit detar dhe shërbimet ose nëpunësit e tjerë të përshtatshëm të raportojnë pa vonesë çdo ngjarje të vërejtur në det ose në port detar apo një mjet për trajtimin e naftës që ka të bëjë me derdhjen e naftës ose praninë e naftës organit të brendshëm kompetent ose, sipas rastit, shtetit më të afërt bregdetar;

e) i kërkon pilotëve të avionëve civilë të raportojnë pa vonesë çdo ngjarje të vërejtur në det që ka

të bëjë me një derdhje të naftës ose praninë e naftës shtetit më të afërt bregdetar.

2. Raportet në bazë të paragrafit (1)(a)(i) bëhen në pajtim me kërkesat e zhvilluara nga Organizata dhe bazuar në udhëzimet dhe parimet e përgjithshme të miratuara nga Organizata. Raportet në bazë të paragrafit (1)(a)(ii), (b), (c) dhe (d) bëhen në pajtim me udhëzimet dhe parimet e përgjithshme të miratuara nga Organizata në masën e zbatueshme.

Neni 5

Masat me marrjen e një raporti për ndotje nga nafta

1. Kurdoherë që një Palë merr një raport sipas nenit 4 apo informacion për ndotje, të dhëna nga burime të tjera, ajo:

- a) vlerëson ngjarjen për të caktuar nëse ajo është një incident i ndotjes nga nafta;
- b) vlerëson natyrën, masën dhe pasojat e mundshme të incidentit të ndotjes nga nafta; dhe
- c) pastaj pa vonesë informon të gjitha shtetet, interesat e të cilëve preken ose mund të preken nga një incident i tillë i ndotjes nga nafta, së bashku me:
 - i) detajet e vlerësimeve të saj dhe çdo masë që ajo ka marrë ose ka ndër mend të marrë si kundërveprim ndaj incidentit; dhe
 - ii) informacione të tjera sipas rastit, deri në përfundimin e masës së marrë si kundërveprim ndaj incidentit ose derisa veprimi i përbashkët të jetë vendosur nga këto shtete.

2. Nëse justifikohet nga ashpërsia e incidentit të ndotjes nga nafta, Pala duhet t'i paraqesë Organizatës drejtpërdrejt ose, sipas rastit, nëpërmjet organizatave ose masave përkatëse rajonale, informacionin e përmendur në paragrafin (1)(b) dhe (c).

3. Nëse justifikohet nga ashpërsia e incidentit të ndotjes nga nafta, shtetet e tjera të prekura prej tij nxiten të informojnë Organizatën drejtpërdrejt ose, sipas rastit, nëpërmjet organizatave ose masave përkatëse rajonale në lidhje me vlerësimin e masës së rrezikut për interesat e tyre dhe masat e marra apo të synuara.

4. Palët duhet të përdorin, sipas rastit, sistemin e raportimit të ndotjes nga nafta të zhvilluar nga Organizata gjatë shkëmbimit të informacionit dhe komunikimit me shtetet e tjera dhe Organizatën.

Neni 6

Sistemet kombëtare dhe rajonale për përgatitjen dhe reagimin

1. Secila Palë ngre një sistem kombëtar për të reaguar menjëherë dhe me efektivitet kundrejt incidenteve të ndotjes nga nafta. Ky sistem përfshin minimalisht:

- a) caktimin e:
 - i) autoritetit ose autoriteteve kompetente kombëtare me përgjegjësinë për gatishmërinë dhe reagimin kundrejt ndotjes nga nafta;
 - ii) pikën ose pikat operacionale kombëtare të kontaktit, që janë përgjegjëse për marrjen dhe transmetimin e raporteve të ndotjes nga nafta sipas parashikimit të nenit 4; dhe
 - iii) një autoritet që ka të drejtë të veprojë në emër të shtetit për të kërkuar asistencë ose të vendosë për të dhënë asistencën e kërkuar.
- b) një plan kombëtar emergjence për gatishmërinë dhe përgjigjen që përfshin raportin organizativ të të gjithë organeve të përfshira, qofshin publike apo private, duke marrë parasysh udhëzimet e zhvilluara nga Organizata.

2. Po kështu, secila Palë, brenda aftësive të saj individualisht apo nëpërmjet bashkëpunimit dypalësh ose shumëpalësh dhe, sipas rastit, në bashkëpunim me industrinë e naftës dhe të transportit, autoritetet e portit dhe subjektet e tjera përkatëse, do të caktojnë:

- a) një nivel minimal të pajisjeve paraprake si masë kundër derdhjes së naftës, në proporcion me rrezikun përkatës dhe programet për përdorimin e tyre;
- b) një program ushtrimesh për organizatat e reagimit ndaj ndotjes nga nafta dhe trajnim për personelin përkatës;
- c) plane të detajuara dhe aftësitë e komunikimit për të reaguar kundrejt një incidenti të ndotjes nga nafta. Këto aftësi duhet të jenë gjithmonë funksionale; dhe
- d) një mekanizëm ose masa për të bashkërenduar reagimin kundrejt një incidenti të ndotjes nga nafta, sipas rastit, me aftësitë për të mobilizuar burimet e nevojshme.

3. Secila Palë siguron që informacioni i kohës t'i jepet Organizatës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet

organizatës apo masave përkatëse rajonale, në lidhje me:

- a) vendndodhjen, të dhënat e telekomunikimit dhe, sipas rastit, zonën e përgjegjësisë së autoriteteve të parashikuar në paragrafin (1)(a);
- b) informacionin në lidhje me pajisjet e reagimit ndaj ndotjes dhe ekspertizën në disiplinat në lidhje me reagimin kundrejt ndotjes nga nafta dhe shpëtimin detar që mund t'u ofrohet shteteve të tjera, me kërkesë; dhe
- c) planin e vet kombëtar të emergjencës.

Neni 7

Bashkëpunimi ndërkombëtar në reagimin ndaj ndotjes

1. Palët bien dakord që në pajtim me aftësitë e tyre dhe pasjen e burimeve përkatëse, ato do të bashkëpunojnë dhe japin shërbime këshilluese, mbështetje dhe pajisje teknike për qëllimin e reagimit kundrejt një incidenti të ndotjes nga nafta, nëse ashpërsia e një incidenti të tillë e justifikon këtë, me kërkesë të çdo Pale të prekur ose që mund të preket. Financimi i shpenzimeve për një asistencë të tillë bazohet në dispozitat që ndodhen në aneksin e kësaj Konvente.

2. Një Palë që ka kërkuar asistencë mund t'i kërkojë Organizatës të asistojë në identifikimin e burimeve të financimit provizor të shpenzimeve, të përmendura në paragrafin (1).

3. Në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme, secila Palë merr masat e nevojshme ligjore ose administrative për të lehtësuar:

a) mbërritjen, përdorimin dhe largimin nga territori i tij të anijeve, avionëve dhe mjeteve të tjera të transportit të përfshira në reagimin kundrejt një incidenti të ndotjes nga nafta ose personelit transportues, mallrave, materialeve dhe pajisjeve të kërkuara për të trajtuar një incident të tillë; dhe

b) lëvizjen e shpejtë në, përmes dhe nga territori i tij të personelit, mallrave, materialeve dhe pajisjeve të përmendura në nënparagrafin (a).

Neni 8

Kërkimi dhe zhvillimi

1. Palët bien dakord të bashkëpunojnë drejtpërdrejt ose, sipas rastit, me anë të Organizatës ose organizatave ose masave përkatëse rajonale, për nxitjen dhe shkëmbimin e rezultateve të programeve të kërkimit dhe zhvillimit në lidhje me forcimin e gatishmërisë dhe reagimit kundrejt gjendjes së llojit të ndotjes nga nafta, duke përfshirë teknologjitë dhe teknikat e vrojtimit, kontrollit, përmirësimit, shpërndarjes, pastrimit dhe minimizimit apo zbutjes së efekteve të ndotjes nga nafta dhe për restaurimin.

2. Për këtë qëllim, Palët marrin përsipër të vendosin, sipas rastit, nëpërmjet Organizatës ose organizatave apo masave të përshtatshme rajonale, lidhjet e nevojshme ndërmjet institucioneve kërkimore të Palëve.

3. Palët bien dakord të bashkëpunojnë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Organizatës apo organizatave ose masave përkatëse rajonale, të nxisin, sipas rastit, organizimin mbi një bazë të qëndrueshme të simpoziumeve ndërkombëtare mbi temat përkatëse, duke përfshirë përparimet teknologjike në teknikat dhe pajisjet e luftës kundër ndotjes nga nafta.

4. Palët bien dakord të inkurajojnë, nëpërmjet Organizatës apo organizatave të tjera ndërkombëtare, zhvillimin e standardeve për teknika dhe pajisje të përshtatshme për luftën kundër ndotjes nga nafta.

Neni 9

Bashkëpunimi teknik

1. Palët marrin përsipër, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Organizatës dhe organeve të tjera ndërkombëtare, sipas rastit, në lidhje me gatishmërinë dhe reagimin ndaj ndotjes nga nafta, të japin mbështetje për ato Palë që kërkojnë asistencë teknike:

- a) për trajnimin e personelit;
- b) për sigurimin e ofrimit të teknologjisë, pajisjeve dhe mjeteve përkatëse;
- c) për lehtësimin e masave dhe planeve të tjera për t'u përgatitur dhe reaguar kundrejt incidenteve të ndotjes nga nafta; dhe
- d) për fillimin e programeve të përbashkëta të kërkimit dhe zhvillimit.

2. Palët marrin përsipër të bashkërendojnë në mënyrë aktive, në pajtim me ligjet e tyre të

brendshme, në transferimin e teknologjisë në lidhje me gatishmërinë dhe reagimin ndaj ndotjes nga nafta.

Neni 10

Nxitja e bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh në gatishmëri dhe reagim

Palët marrin përsipër të lidhin marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe për gatishmërinë dhe reagimin kundrejt ndotjes nga nafta. Kopje të këtyre marrëveshjeve i komunikohen Organizatës që ua ofron Palëve me kërkesë.

Neni 11

Raporti me konventat dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Asgjë në këtë Konventë nuk interpretohet si ndryshim i të drejtave ose detyrimeve të një Pale në bazë të një konvente apo marrëveshjeje tjetër ndërkombëtare.

Neni 12

Masat institucionale

1. Palët i ngarkojnë Organizatës, në pajtim me marrëveshjen e saj dhe pasjen e burimeve të përshtatshme për të nxitur aktivitetin, të kryejë funksionet dhe aktivitetet e mëposhtme:

a) shërbimet e informimit:

i) të marrë, mbledhë, shpërndajë me kërkesë, informacionin e dhënë nga Palët (shih për shembull nenet 5(2) dhe (3), 6(3) dhe 10) dhe informacionin përkatës të dhënë nga burime të tjera; dhe

ii) të japë asistencë në identifikimin e burimeve të financimit provizor të shpenzimeve (shih, për shembull nenin 7(2)).

b) edukimin dhe trajnimin:

i) të nxisë trajnimin në sferën e gatishmërisë dhe reagimit ndaj ndotjes nga nafta (shih për shembull nenin 9); dhe

ii) të nxisë mbajtjen e simpoziumeve ndërkombëtare (shih për shembull nenin 8(3).

c) shërbimet teknike:

i) të lehtësojë bashkëpunimin në kërkim dhe zhvillim (shih për shembull nenet 8(1), (2) dhe (4) dhe 9(1)(d);

ii) t'u japë asistencë shteteve që ngrenë struktura kombëtare dhe rajonale të reagimit; dhe

iii) të analizojë informacionin e dhënë nga Palët (shih për shembull nenet 5(2) dhe (3), 6(3) dhe 8(1) dhe informacionin përkatës të dhënë nga burime të tjera dhe t'u japë shteteve këshillim ose informacion.

d) asistencë teknike:

i) të nxisë dhënien e asistencës teknike për shtetet që ngrenë strukturat kombëtare dhe rajonale të reagimit; dhe

ii) të nxisë dhënien e asistencës teknike dhe këshillimit, me kërkesë të shteteve që përballen me incidente të ndotjes së konsiderueshme nga nafta.

2. Në kryerjen e aktiviteteve të parashikuara në këtë nen, Organizata përpaket të forcojë aftësinë e shteteve, individualisht ose nëpërmjet masave rajonale, për t'u përgatitur dhe për të luftuar incidentet e ndotjes nga nafta, duke iu referuar eksperiencës së shteteve, marrëveshjeve rajonale dhe masave industriale dhe duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të vendeve në zhvillim.

3. Dispozitat e këtij neni zbatohen në pajtim me një program të zhvilluar dhe mbajtur në vëzhgim nga Organizata.

Neni 13

Vlerësimi i Konventës

Palët vlerësojnë brenda Organizatës efektivitetin e Konventës nën dritën e objektivave të saj, veçanërisht në lidhje me parimet që nënvizojnë bashkëpunimin dhe asistencën.

Neni 14
Ndryshimet

1. Kjo Konventë mund të ndryshohet me një nga procedurat e parashikuara në paragrafët e mëposhtëm.

2. Ndryshimi pas shqyrtimit nga Organizata:

a) Çdo ndryshim i propozuar nga një Palë në Konventë i paraqitet Organizatës dhe qarkullohet nga Sekretari i Përgjithshëm te të gjithë anëtarët e Organizatës dhe të gjitha Palët të paktën gjashtë muaj para shqyrtimit të saj.

b) Çdo ndryshim i propozuar dhe qarkulluar si më sipër i paraqitet për shqyrtim Komitetit të Mbrojtjes së Ambientit Detar të Organizatës.

c) Palët në Konventë, pavarësisht nëse janë anëtarë ose jo të Organizatës, kanë të drejtë të marrin pjesë në punimet e Komitetit të Mbrojtjes së Ambientit Detar.

d) Ndryshimet miratohen nga një shumicë prej dy të tretash e vetëm Palëve të Konventës që janë të pranishme dhe marrin pjesë në votim.

e) Nëse miratohet në pajtim me nënparagrafin (d), ndryshimet u komunikohen nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha Palëve të Konventës për praninë.

f) (i) Një ndryshim i një neni ose aneksi të Konventës konsiderohet të jetë pranuar në datën në të cilën ai pranohet nga dy të tretat e Palëve.

ii) Një ndryshim në një shtojcë konsiderohet të jetë pranuar në fund të një afati që caktohet nga Komiteti i Mbrojtjes së Ambientit Detar në momentin e miratimit, dhe ky afat nuk është më i shkurtër se dhjetë muaj, përveç kur brenda këtij afati Sekretarit të Përgjithshëm i komunikohet një kundërshtim nga jo më pak se një e treta e Palëve.

g) (i) Një ndryshim në një nen ose aneks të Konventës, i pranuar në pajtim me nënparagrafin (f)(i), hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës në të cilën konsiderohet të jetë pranuar në lidhje me Palët që kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm që e kanë miratuar atë.

ii) Një ndryshim në shtojcën e pranuar në pajtim me nënparagrafin (f)(ii) hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës në të cilën mendohet të jetë pranuar në lidhje me të gjitha Palët, me përjashtim të atyre që, para asaj date, e kanë kundërshtuar atë. Një Palë mund ta tërheqë një kundërshtim të komunikuar më parë në çdo kohë, duke i paraqitur një njoftim për këtë qëllim Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Ndryshimi nga Konferenca:

a) Me kërkesë të një Pale, të mbështetur nga të paktën një e treta e Palëve, Sekretari i Përgjithshëm thërret një Konferencë të Palëve në Konventë për të shqyrtuar ndryshimet në Konventë.

b) Një ndryshim i miratuar nga një Konferencë e tillë nga një shumicë prej dy të tretave të Palëve, që janë të pranishme dhe marrin pjesë në votim, u komunikohet nga Sekretari i Përgjithshëm të gjithë Palëve për të dhënë pëlqimin e tyre.

c) Përveç kur Konferenca vendos ndryshe, ndryshimi konsiderohet të jetë pranuar dhe të ketë hyrë në fuqi në pajtim me procedurat e parashikuara në paragrafin (2)(f) dhe (g).

4. Miratimi dhe hyrja në fuqi e një ndryshimi që përbën një shtesë në aneks ose shtojcë i nënshtrohet procedurës që zbatohet për një ndryshim në aneks.

5. Çdo Palë që nuk ka pranuar një ndryshim në këtë nen ose në aneks në bazë të paragrafit (2)(f)(i) ose një ndryshim që përbën një shtesë në një aneks ose një shtojcë në bazë të paragrafit (4) apo ka komunikuar një kundërshtim për një ndryshim të një shtojce në bazë të paragrafit (2)(f)(ii), trajtohet si jopalë vetëm për qëllimet e zbatimit të një ndryshimi të tillë. Ky trajtim përfundon me paraqitjen e një njoftimi për pranimin në bazë të paragrafit (2)(f)(i) ose tërheqjen e kundërshtimit në bazë të paragrafit (2)(g)(ii).

6. Sekretari i Përgjithshëm informon të gjitha Palët për çdo ndryshim që hyn në fuqi në bazë të këtij neni, së bashku me datën në të cilën hyn në fuqi një ndryshim i tillë.

7. Çdo njoftim pranimi, kundërshtimi ose tërheqjeje kundërshtimi të një ndryshimi në bazë të këtij neni i komunikohet me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm që informon Palët për një njoftim të tillë dhe datën e marrjes së tij.

8. Një shtojcë e Konventës përmban vetëm dispozita të një natyre teknike.

Neni 15
Firmosja, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë mbetet e hapur për nënshkrim në selinë e Organizatës nga 30 nëntori 1990 deri

më 29 nëntor 1991 dhe pas kësaj mbetet e hapur për aderim. Çdo shtet mund të bëhet Palë në këtë Konventë nëpërmjet:

- a) nënshkrimit pa rezervë në lidhje me ratifikimin, pranimin apo aprovimin; ose
- b) nënshkrimit duke iu nënshkruar ratifikimit, pranimin ose aprovimin që pasohet nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi; ose
- c) aderimit.

2. Ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi realizohet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim te Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 16

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën jo më pak se pesëmbëdhjetë shtete e kanë nënshkruar ato pa rezervën e ratifikimit, pranimin ose aprovimin, ose kanë depozituar instrumentet e duhura të ratifikimit, pranimin, aprovimin ose aderimit, në pajtim me nenin 15.

2. Për shtetet që kanë depozituar një instrument ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi në lidhje me këtë Konventë, pasi të jenë përmbushur kërkesat për hyrjen e saj në fuqi por para datës së hyrjes së saj në fuqi, ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi hyn në fuqi, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente ose tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit, cilado që të jetë data e mëvonshme.

3. Për shtetet që kanë depozituar një instrument ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi pas datës në të cilën kjo Konventë ka hyrë në fuqi, kjo Konventë hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit.

4. Pas datës në të cilën një ndryshim i kësaj Konvente mendohet të jetë pranuar në bazë të nenit 14, çdo instrument ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi i depozituar zbatohet për këtë Konventë të ndryshuar.

Neni 17

Denoncimi

1. Kjo Konventë denoncohet nga çdo Palë në çdo kohë pas kalimit të pesë viteve nga data në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për atë Palë.

2. Denoncimi realizohet nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Një denoncim hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit nga Sekretari i Përgjithshëm ose pas kalimit të një afati më të gjatë që mund të tregohet në njoftim.

Neni 18

Depozituesi

1. Kjo Konventë depozitohet te Sekretari i Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm:

- a) informon të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Konventë ose kanë aderuar në të për:
 - i) çdo nënshkrim ose depozitim të ri të një instrumenti ratifikimi, pranimi, aprovimi ose aderimi, së bashku me datën e tij;
 - ii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente; dhe
 - iii) depozitimin e çdo instrumenti denoncimi të kësaj Konvente, së bashku me datën në të cilën ai është marrë dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi.
- b) u transmeton kopje të vërtetuara të kësaj Konvente qeverive të të gjitha shteteve që kanë nënshkruar këtë Konventë apo kanë aderuar në të.

3. Menjëherë sapo kjo Konventë të hyjë në fuqi, një kopje e vërtetuar e saj i transmetohet nga depozituesi Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim, në pajtim me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 19

Gjuhët

Kjo Konventë hartohet në një kopje të vetme në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëllor autentik.

Si dëshmi, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar nga qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Londër, në ditën e tridhjetë të nëntorit, njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë.

ANEKS

RIMBURSIMI I SHPENZIMEVE TË ASISTENCËS

1.

a) Nëse nuk është lidhur një marrëveshje në lidhje me rregullimet financiare që rregullojnë veprimet e Palëve për të trajtuar incidentet e ndotjes nga nafta mbi një bazë dypalëshe ose shumëpalëshe, Palët mbulojnë shpenzimet e veprimeve të tyre përkatëse për trajtimin e ndotjes në pajtim me nënparagrafin (i) ose nënparagrafin (ii).

i) Nëse veprimi është ndërmarrë nga një Palë me kërkesën konkrete të një Pale tjetër, Pala kërkuuese i rimbursion Palës që jep ndihmën shpenzimet e veprimit. Pala kërkuuese mund të anulojë kërkesën e saj në çdo kohë, por në këtë rast ajo mbulon shpenzimet e shkaktuara apo të kryera nga Pala që jep ndihmën.

ii) Nëse veprimi ndërmerret nga njëra Palë me iniciativën e saj, kjo Palë përballon shpenzimet e veprimit të saj.

b) Parimet e parashikuara në nënparagrafin (a) zbatohen përveç kur Palët e interesuara bien dakord ndryshe në çdo rast të veçantë.

2. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe, shpenzimet e veprimit të ndërmarrë nga një Palë me kërkesë të një Pale tjetër llogariten drejt, në pajtim me ligjin dhe praktikën e tashme të Palës që jep ndihmën në lidhje me rimbursimin e këtyre shpenzimeve.

3. Pala që kërkon ndihmë dhe Pala që jep ndihmë, sipas rastit, bashkëpunojnë në arritjen e një veprimi si reagim ndaj një pretendimi për kompensim. Për këtë qëllim, ata i kushtojnë vëmendjen e duhur regjimeve ligjore ekzistuese. Nëse veprimi i arritur në këtë mënyrë nuk lejon kompensimin e plotë për shpenzimet që shkaktohen në operacionin e ndihmës, Pala që kërkon ndihmë mund t'i kërkojë Palës që jep ndihmë të heqë dorë nga rimbursimi i shpenzimeve që tejkalojnë shumat e kompensuara ose të pakësojnë shpenzimet që janë llogaritur në pajtim me paragrafin (2). Ajo mund të kërkojë gjithashtu edhe shtyrjen e rimbursimit të këtyre shpenzimeve. Në shqyrtimin e një kërkesë të tillë, Palët që japin ndihmë, i kushtojnë vëmendjen e duhur nevojave të vendeve në zhvillim.

4. Dispozitat e kësaj Konvente nuk interpretohen në ndonjë mënyrë që të cenojnë të drejtat e Palëve për të marrë nga palët e treta shpenzimet e veprimeve për trajtimin e ndotjes ose kërcënimin e ndotjes në bazë të dispozitave të tjera të zbatueshme dhe rregullave të së drejtës së brendshme dhe ndërkombëtare. Vëmendje e veçantë i kushtohet Konventës Ndërkombëtare të vitit 1969 mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmet nga Ndotja nga Nafta dhe Konventës Ndërkombëtare të vitit 1971 mbi Ngritjen e një Fondi Ndërkombëtar për Kompensimin për Dëmin nga Ndotja nga Nafta ose çdo ndryshimi të mëvonshëm të këtyre konventave.

SHTOJÇË

REZOLUTA 1 E KONFERENCËS

REFERENCAT NË INSTRUMENTE DHE DOKUMENTE TË TJERA, TË ZHVILLUARA
NGA ORGANIZATA DETARE NDËRKOMBËTARE NË BAZË TË NENEVE TË KONVENTËS
NDËRKOMBËTARE TË GATISHMËRISË, REAGIMIT DHE BASHKËPUNIMIT NDAJ NDOTJES
NGA NAFTA, 1990

Konferenca,
duke miratuar Konventën Ndërkombëtare të Gatishmërisë, Reagimit dhe Bashkëpunimit ndaj
Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC);

duke njohur që masat e paraqitura nga Konventa OPRC marrin parasysh dispozitat e konventave të

tjera të rëndësishme të zhvilluara nga Organizata Ndërkombëtare Detare, veçanërisht Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjeve nga Anijet, 1973, e ndryshuar nga protokoli i vitit 1978, e ndryshuar (MARPOL 73/78);

duke njohur gjithashtu nevojën për Konventën OPRC për të plotësuar dhe jo dyzuar dispozitat e rëndësishme të miratuara nga ose nën kujdesin e Organizatës, si ato që janë të MARPOL 73/78, udhëzime dhe manuale;

duke vënë re që nenet 3, 4, 5 dhe 6 të Konventës OPRC u referohen veçanërisht dispozitave të caktuara në MARPOL 73/78 dhe dokumenteve të tjera të zhvilluara nga Organizata:

1. *miraton* listën që përmban referencat në instrumente dhe dokumente të zhvilluara nga Organizata në bazë të neneve përkatëse të Konventës OPRC, siç përcaktohet në aneksin e kësaj rezolute;

2. *fton* Komitetin e Mbrojtjes së Ambientit Detar të Organizatës për të mbajtur listën të përditësuar;

3. *i kërkon* Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës t'i përfshijë këto referenca, të përditësuara sipas nevojës, në botimet e ardhshme të Konventës OPRC në formën e shkrimeve fundore për nenet përkatëse.

ANEKS

REFERENCAT NË KONVENTËN OPRC

Neni 3 (1)(a)

“Dispozitat e miratuara nga Organizata” i referohen rregullores 26 të aneksit I të MARPOL 73/78.

Neni 3 (1)(b)

“Masat ekzistuese ndërkombëtare” i referohen neneve 5 dhe 7 të MARPOL 73/78.

Neni 4 (2)

“Kërkesat e zhvilluara nga Organizata” i referohen nenit 8 të protokollit I të MARPOL 73/78.

“Udhëzimet dhe parimet e përgjithshme të miratuara nga Organizata” i referohen “Parimeve të përgjithshme për sistemin e raportimit të anijeve dhe kërkesave të raportimit të anijeve, duke përfshirë udhëzimet për raportimin e incidenteve që përfshijnë mallra të rrezikshme, substanca të dëmshme dhe/ose ndotës detarë”, të miratuara nga Organizata me anë të rezolutës A. 648(16).

Neni 5(4)

“Sistemi i raportimit të ndotjes nga nafta, e zhvilluar nga Organizata” përmbahet në manualin mbi Ndotjen nga Nafta, seksioni II – Planifikimi i Ngjarjeve të Paparashikuara, shtojca 2, e zhvilluar nga Komiteti i Mbrojtjes së Ambientit Detar i Organizatës.

Neni 6(1)(b)

“Udhëzimet e zhvilluara nga Organizata” përmbahen në manualit mbi Ndotjen nga Nafta, seksioni II – Planifikimi për Ngjarjet e Paparashikuara, e zhvilluar nga Komiteti i Mbrojtjes së Ambientit Detar i Organizatës.

REZOLUTA 2 E KONFERENCËS

ZBATIMI I KONVENTËS NDËRKOMBËTARE MBI GATISHMËRINË, REAGIMIN DHE BASHKËPUNIMIN PËR NDOTJEN NGA NAFTA, 1990, NË PRITJE TË HYRJES SË SAJ NË FUQI

Konferenca,

duke miratuar Konventën Ndërkombëtare mbi Gatishmërinë, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC);

duke njohur rrezikun e vazhdueshëm për një incident të një ndotjeje të konsiderueshme nga nafta dhe pasojat serioze për ambientin që mund të lindin nga kjo;

të bindur për rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet shteteve në shkëmbimin e informacionit dhe asistencës, duke respektuar gatishmërinë dhe reagimin ndaj ndotjes nga nafta;

duke ditur ndikimin e veçantë ndaj atyre vendeve që nuk kanë mundësinë e informimit dhe të këshillimit mbi gatishmërinë dhe reagimin ndaj ndotjes nga nafta;

duke njohur më tej që për çdo vend të rrezikuar nga incidentet e ndotjes nga nafta është e dëshirueshme të ngrihet një sistem i brendshëm për luftën kundër ndotjes nga nafta;

me dëshirën që dispozitat e Konventës OPRC të marrin fuqi sa më parë të jetë e mundur, për të

lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar në gatishmërinë dhe reagimin ndaj ndotjes nga nafta:

1. *u bën thirrje* shteteve, duke përfshirë ato që nuk kanë marrë pjesë në këtë Konferencë, të nënshkruajnë dhe të bëhen Palë në Konventën OPRC dhe të zbatojnë dispozitat e saj sa më parë të jetë e mundur;

2. *i nxit* të gjitha shtetet të ngrenë sa më parë të jetë e mundur, sisteme të brendshme për të luftuar kundër ndotjes nga nafta;

3. *nxit më tej* të gjitha shtetet, në pritje të hyrjes në fuqi të Konventës OPRC për ta, të bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe me Organizatën Ndërkombëtare Detare, sipas rastit, në shkëmbimin e informacionit për luftën kundër ndotjes nga nafta dhe në lehtësimin e asistencës së menjëhershme në rastin e një incidenti të ndotjes së konsiderueshme nga nafta.

REZOLUTA 3 E KONFERENCËS

ZBATIMI I PARAKOHSHËM I DISPOZITAVE TË NENIT 12 TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE MBI GATISHMËRINË, REAGIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDAJ NDOTJES NGA NAFTA, 1990

Konferenca,

duke miratuar Konventën Ndërkombëtare mbi Gatishmërinë, Reagimin dhe Bashkëpunimin e Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC);

duke pasur parasysh dispozitat e rezolutës A.448(XI) të Asamblesë së Organizatës Ndërkombëtare Detare mbi masat rajonale për luftën kundër incidenteve të konsiderueshme ose kërcënimeve të ndotjes detare, dhe më tej rezolutat e Asamblesë mbi asistencën teknike në fushën e mbrojtjes së ambientit detar (A.349(IX), A.677(16));

duke pasur parasysh gjithashtu, veçanërisht, që neni 12 i Konventës OPRC me anë të së cilës Palët i ngarkuan IMO-s, në bazë të marrëveshjes së saj dhe ekzistencës së burimeve të përshtatshme, të ushtrijë aktivitetin, funksionet dhe veprimet e caktuara dhe të arrijë objektiva të caktuara të Konventës së OPRC-së;

duke pasur parasysh edhe rëndësinë e marrjes parasysh të eksperiencës së fituar brenda marrëveshjeve rajonale për luftën kundër ndotjes detare sipas referencës së rezolutës A.674(16) të Asamblesë;

duke njohur rëndësinë e zbatimit të parakohshëm të objektivave të nenit 12 të Konventës OPRC:

1. *fton* Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës, në pritje të hyrjes në fuqi të Konventës OPRC, të fillojë zbatimin e parakohshëm të funksioneve dhe aktiviteteve, me qëllim që të arrihen objektivat e neneve 12(1)(a) dhe (b) të Konventës OPRC brenda burimeve ekzistuese;

2. *fton* Organizatën të ofrojë një forum për të diskutuar eksperiencat e fituara brenda marrëveshjeve dhe konventave rajonale në lidhje me incidentet e ndotjes nga nafta;

3. *i kërkon* Sekretarit të Përgjithshëm t'i paraqesë Organizatës, brenda një viti nga kjo Konferencë, një program që të tregojë mënyrën në të cilën Organizata parashikon zbatimin e detyrave të përmendura në këtë Konventë, dhe që do të përfshinin elemente të tilla, si ricaktimi i fondeve ekzistuese, shqyrtimi dhe zhvillimi i masave organizative alternative dhe përcaktimi i implikimeve financiare dhe burimeve të mundshme të mbështetjes;

4. *fton më tej* Organizatën të rishikojë periodikisht përparimin e bërë në zbatim të nenit 12 të Konventës OPRC.

REZOLUTA 4 E KONFERENCËS

ZBATIMI I DISPOZITAVE TË NENIT 6 TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE MBI GATISHMËRINË, REAGIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDAJ NDOTJES NGA NAFTA, 1990

Konferenca,

duke miratuar Konventën Ndërkombëtare mbi Gatishmërinë, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta (Konventa OPRC);

duke njohur rëndësinë e parimit “ndotësi paguan”;

duke vënë re që neni 6 i Konventës OPRC parashikon që Palët do të ngrenë një sistem kombëtar që përbëhet nga një plan për ngjarjet e paparashikuara dhe marrin masa, individualisht ose në bashkëpunim me Palët e tjera, që konsistojnë veçanërisht në pajisjet e reagimit dhe në një program trajnimi;

duke qenë të ndërgjegjshëm se në rastin e një incidenti të ndotjes nga nafta, masat e menjëhershme të marra nga shteti i kërcënuar janë thelbësore dhe ka mundësi që në fazën fillestare të jenë më të efektshme në mbrojtjen e brigjeve të tij dhe minimizimin e dëmit të mundshëm të shkaktuar nga një incident i tillë;

duke theksuar që kur kërkohet asistencë ndërkombëtare nga shteti i kërcënuar, dërgimi i personelit dhe pajisjeve mund të kërkojë një kohë të caktuar si rezultat i distancës;

duke theksuar më tej që efektiviteti i asistencës varet nga masat e marra për t'u përgatitur për reagimin dhe për të trajnuar personelin për të zbatuar planin kombëtar për ngjarjet e paparashikuara të shtetit të kërcënuar;

duke pasur parasysh se burimet financiare që kanë disa vende në zhvillim janë të kufizuara;

duke njohur gjithashtu që masat e marra për t'u përgatitur për reagimin bëjnë të nevojshme ndihmën financiare specifike që ofrohet për këtë qëllim, për t'u përfutur nga vendet në zhvillim:

1. *fton* Palët që në programet e tyre të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh dhe në kushte të drejta, t'u kushtojnë vëmendjen e duhur nevojave të vendeve në zhvillim që rrjedhin nga zbatimi i Konventës OPRC;

2. *fton gjithashtu* Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës të japë mbështetjen e tij në identifikimin e organeve ndërkombëtare që mund të japin burime specifike financimi për të asistuar vendet në zhvillim në përmbushjen e detyrimeve të tyre që rrjedhin nga Konventa OPRC.

REZOLUTA 5 E KONFERENCËS

KRIJIMI I PAJISJEVE DHE REZERVAVE PËR TË LUFTUAR NDOTJEN NGA NAFTA

Konferenca,

duke miratuar Konventën Ndërkombëtare mbi Gatishmërinë, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC);

duke vënë re nenin 6(2)(a) të Konventës OPRC që parashikon se secila Palë, brenda mundësive të saj, individualisht ose me anë të bashkëpunimit, dypalësh ose shumëpalësh, dhe sipas rastit, në bashkëpunim me industrinë e transportit detar dhe të naftës dhe subjekte të tjera, do të ngrejë një sistem që përfshin nivelin minimal të pajisjeve të paravendosura të luftës kundër derdhjes së naftës dhe të programeve për përdorimin e saj;

duke vënë re gjithashtu që një nga elementet kryesore të strategjisë së Organizatës Ndërkombëtare Detare për mbrojtjen e ambientit detar është forcimi i kapacitetit për veprim kombëtar dhe rajonal për të luftuar ndotjen detare dhe për të nxitur bashkëpunimin teknik për këtë qëllim;

duke njohur që në rastin e derdhjes së naftës ose të kërcënimit të saj, duhet të veprohet shpejt dhe me efektivitet, fillimisht në nivel kombëtar, për të organizuar dhe bashkërenduar aktivitetet e parandalimit, zbutjes dhe pastrimit;

duke njohur gjithashtu që një nga parimet bazë të përdorura për dhënien e fondeve pas ndodhjes së dëmit nga ndotja, është parimi "ndotësi paguan";

duke njohur më tej rëndësinë e bashkëpunimit reciprok dhe asistencës në luftën kundër incidenteve të ndotjes së konsiderueshme nga nafta që mund të jetë tej aftësisë së vendeve dhe nevojën për të përforcuar pajisjet për luftën kundër derdhjes së naftës që ekzistojnë në rajone të caktuara të botës që janë veçanërisht të prekshme nga incidenti i ndotjes së konsiderueshme nga nafta për shkak të densitetit të lartë të trafikut të mjeteve të lundrimit ose kushteve veçanërisht të ndjeshme ekologjike;

duke njohur aktivitetet e Organizatës, në bashkëpunim me vende të tjera donatore dhe industrinë, në krijimin e rezervave të pajisjeve ose qendrave për luftën kundër derdhjes së naftës në zonat ku veçanërisht vendet në zhvillim janë të prekshme ose të rrezikuara nga një incident i ndotjes së konsiderueshme nga nafta;

fton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës, duke u konsultuar me Drejtorin Ekzekutiv të Programit të Kombeve të Bashkuara për Ambientin, t'u drejtohet industrive të naftës dhe transportit detar, me qëllim që:

a) të inkurajojnë bashkëpunimin e mëtejshëm për të asistuar vendet në zhvillim për të zbatuar nenin 6 të Konventës OPRC, duke përfshirë një vlerësim të nevojës për rezerva të pajisjeve për luftën kundër derdhjes së naftës mbi baza rajonale dhe nënrajonale, përveç atyre tashmë të krijuara;

b) të zhvillojnë një plan për krijimin e rezervave të pajisjeve për luftën kundër derdhjes së naftës mbi një bazë rajonale dhe nënrajonale, me qëllim që të asistojnë vendet në zhvillim në zbatimin e nenit 6(2)(a) të Konventës OPRC.

REZOLUTA 6 E KONFERENCËS

NXITJA E ASISTENCËS TEKNIKE

Konferenca,
duke miratuar Konventën Ndërkombëtare mbi Gatishmërinë, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC);

duke vënë re që elementet kyçe në suksesin e çdo veprimi për të luftuar ndotjen detare, janë organizimi i mirë administrativ në vendet e interesuara në këtë fushë dhe të paktën një minimum i përgatitjes teknike;

duke qenë e ndërgjegjshme për vështirësitë që mund të hasen nga vende të caktuara në zhvillim në ngritjen e një organizimi të tillë dhe përgatitjen me anë të burimeve të tyre;

duke njohur rolin e luajtur në këtë kontekst nga Organizata Ndërkombëtare Detare, nga marrëveshjet rajonale, bashkëpunimi dypalësh dhe programet e industrisë;

duke njohur gjithashtu kontributin e dhënë nga programi i bashkëpunimit teknik të Organizatës, Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara, Programi i Ambientit i Kombeve të Bashkuara dhe agjencitë kombëtare të ndihmës në këtë aspekt;

duke ditur gjithashtu rezolutën A.677(16) që fton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës për të bërë mbi baza prioritare një vlerësim të problemeve që hasen nga vendet në zhvillim, me qëllim formulimin e objektivave afatgjatë të programit të asistencës teknike të Organizatës në fushën e ambientit dhe të raportojë rezultatin në sesionin e shtatëmbëdhjetë të Asamblesë së Organizatës;

duke njohur gjithashtu ngritjen e një grupi këshillimi nga Sekretari i Përgjithshëm për këtë qëllim:

1. *u kërkon* shteteve anëtare të Organizatës, në bashkëpunim me Organizatën sipas rastit, shtetet e tjera të interesuara, organizatat kompetente ndërkombëtare ose rajonale dhe programet në industri, të forcojnë veprimin për të ndihmuar vendet në zhvillim, veçanërisht në:

a) trajnimin e personelit;

b) sigurimin e teknologjive, pajisjeve dhe mjeteve përkatëse,

të nevojshme për gatishmërinë dhe reagimin ndaj ndotjes nga nafta, për t'i aftësuar ata të ngrenë të paktën strukturat dhe burimet minimale për luftën kundër incidenteve të ndotjes nga nafta, në raport me rreziqet e perceptuara të këtyre incidenteve;

2. *u kërkon* gjithashtu shteteve anëtare, në bashkëpunim me Organizatën sipas rastit, shtetet e tjera të interesuara, organizatat kompetente ndërkombëtare dhe rajonale dhe programet në industri, të forcojnë veprimin për të asistuar vendet në zhvillim në fillimin e programeve të përbashkëta të kërkimit dhe zhvillimit;

3. *i nxit* shtetet anëtare të kontribuojnë për këto veprime pa vonesë, ndërmjet të tjerash, nëpërmjet bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh;

4. *i kërkon më tej* Organizatës të rivlerësojë parimet që theksojnë bashkëpunimin dhe asistencën në nenet 7, 8 dhe 9 të Konventës OPRC, nën dritën e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Ambientin dhe Zhvillimin të vitit 1992.

REZOLUTA 7 E KONFERENCËS

ZHVILLIMI DHE ZBATIMI I NJË PROGRAMI TRAJNIMI PËR GATISHMËRINË DHE REAGIMIN NDAJ NDOTJES NGA NAFTA

Konferenca,
duke miratuar Konventën Ndërkombëtare mbi Gatishmërinë, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC);

duke vënë re që një element kyç i strategjisë së Organizatës Ndërkombëtare Detare për mbrojtjen e ambientit detar është forcimi i kapacitetit për veprim kombëtar dhe rajonal për të parandaluar, kontrolluar, luftuar dhe zbutur ndotjen detare dhe për të nxitur bashkëpunimin teknik për këtë qëllim;

duke qenë e ndërgjegjshme që mundësia e një shteti për të reaguar ndaj një incidenti të ndotjes nga nafta varet nga pasja e pajisjeve për të luftuar derdhjen e naftës, si dhe e personelit të trajnuar për të reaguar ndaj derdhjes së naftës;

duke njohur rolin e Organizatës në organizimin e kurseve kombëtare, rajonale dhe globale të trajnimit dhe në zhvillimin e ndihmës së trajnimit që synon dhënien e ekspertizës së nevojshme teknike, veçanërisht për vendet në zhvillim, në fushën e luftës kundër incidenteve të ndotjes detare;

duke njohur gjithashtu rolin e Universitetit Botëror Detar dhe degëve të tij në dhënien e mjeteve të trajnimit të nivelit të lartë për personelin, veçanërisht nga vendet në zhvillim;

duke njohur gjithashtu mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, Programit të Kombeve të Bashkuara për Ambientin dhe shumë shteteve anëtare të Organizatës për komponentin e trajnimit të programit të bashkëpunimit teknik të Organizatës;

duke konsideruar nevojën për një përpjekje të përforcuar globale nga të gjithë të interesuarit në transportin detar të naftës dhe ndikimin e tij në ambient drejt zhvillimit të një programi global trajnimi në gatishmërinë dhe reagimin ndaj ndotjes nga nafta:

1. *fton* Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës, në bashkëpunim me qeveritë e interesuara, organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale dhe industrinë e naftës dhe transportit detar, të përpiqet për të zhvilluar një program të plotë trajnimi në fushën e gatishmërisë dhe reagimit ndaj ndotjes nga nafta;

2. *fton gjithashtu* Komitetin e Mbrojtjes së Ambientit Detar të Organizatës, mbi bazën e propozimeve të bëra nga Sekretari i Përgjithshëm, për të shqyrtuar dhe miratuar, sipas rastit, këto programe trajnimi mbi gatishmërinë dhe reagimin ndaj ndotjes nga nafta;

3. *fton gjithashtu* shtetet anëtare të Organizatës të përpiqen të ofrojnë ekspertizën e nevojshme për zhvillimin dhe zbatimin e programit të trajnimit.

REZOLUTA 8 E KONFERENCËS

PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE TË SHPËTIMIT

Konferenca,

duke miratuar Konventën Ndërkombëtare mbi Gatishmërinë, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC);

duke konsideruar nevojën për të siguruar që të ketë kapacitet të mjaftueshëm shpëtimi mbi një bazë mbarëbotërore dhe të vlerësojë dhe shpërblejë funksionin parandalues të shpëtuesit në lidhje me ndotjen detare;

duke rikujtuar që Konventa Ndërkombëtare mbi Shpëtimin e vitit 1989, ku janë prezantuar shtysat për shpëtuesit për të parandaluar ndotjen detare nëpërmjet operacioneve të tyre të shpëtimit, nuk ka hyrë akoma në fuqi;

duke vënë re me interes që Konferenca e Tretë Ndërkombëtare mbi Mbrojtjen e Detit të Veriut vendosi më 8 mars 1990 të ndërmarrë veprim të organizuar brenda Organizatës Ndërkombëtare Detare, me qëllim sigurimin e kapacitetit të mjaftueshëm të shpëtimit mbi bazë mbarëbotërore;

duke njohur ekspertizën dhe eksperiencën e shpëtuesve në operimin me efikasitet të shërbimit të shpëtimit në nivel ndërkombëtar;

duke njohur më tej rolin thelbësor të shpëtuesve, duke reaguar ndaj ndodhjeve që shkaktojnë ose që mund të shkaktojnë ndotje detare;

duke pasur parasysh që ka tregues se një përqindje e konsiderueshme e kapacitetit të përshtatshëm të shpëtimit nuk mund të vazhdojë të ofrohet për qëllime shpëtimi;

duke ditur nevojën për kapacitet të mjaftueshëm shpëtimi në itineraret kryesore të transportit detar për trafikun ndërkombëtar të naftës dhe substancave të tjera të dëmshme:

1. *nxit* shtetet të ratifikojnë ose aderojnë në Konventën Ndërkombëtare mbi Shpëtimin të vitit 1989 sa më shpejt të jetë e mundur;

2. *u kërkon* shteteve anëtare të Organizatës të rishikojnë kapacitetin e shpëtimit që kanë dhe t'i raportojnë Organizatës jo më vonë se një vit pas Konferencës mbi kapacitetet e tyre publike dhe private të shpëtimit që janë të përshtatshme të kryejnë operacione shpëtimi, me qëllim që të parandalojnë ose minimizojnë dëmin në ambientin detar;

3. *u kërkon* shteteve anëtare, bregdeti i të cilave është kërcënuar ose dëmtuar nga incidentet e ndotjes detare, t'i raportojnë Organizatës mbi çdo masë të përshtatshme që ata kanë marrë për të përdorur kapacitetet e shpëtimit si reagim ndaj këtyre incidenteve;

4. *i kërkon* Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës të konsultohet me Bashkimin Ndërkombëtar të Shpëtimit, shpëtuesit, siguruesit, pronarët e anijeve dhe industrinë e naftës mbi ekzistencën e tashme dhe

të ardhme të kapacitetit të shpëtimit dhe të raportojë konstatimet e tij te Komiteti i Mbrojtjes së Ambientit Detar të Organizatës.

REZOLUTA 9 E KONFERENCËS

BASHKËPUNIMI NDËRMJET SHTETEVE DHE SIGURUESVE

Konferenca,
duke miratuar Konventën Ndërkombëtare mbi Gatishmërinë, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC);
duke qenë e ndërgjegjshme në lidhje me vështirësitë që mund të hasen nga një shtet i cenuar nga një incident ndotjeje në marrjen e informacionit të dobishëm dhe të nevojshëm për luftën kundër ndotjes;
duke njohur rolin e rëndësishëm të këshilltarëve dhe ekspertëve teknikë të siguruesve në dhënien e këtij informacioni;
e bindur që është e dëshirueshme të vendoset bashkëpunim i ngushtë ndërmjet shtetit që ka pësuar ndotjen dhe siguruesve;
u kërkon ekspertëve teknikë dhe këshilltarëve të bashkëpunojnë me shtetet, me qëllim që të shkëmbehet informacioni teknik, për të lejuar reagimin e efektshëm në rastin e një incidenti të ndotjes nga nafta.

REZOLUTA 10 E KONFERENCËS

ZGJERIMI I OBJEKTIT TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE MBI GATISHMËRINË, REAGIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDAJ NDOTJES NGA NAFTA, 1990, PËR TË PËRFSHIRË SUBSTANCAT E RREZIKSHME DHE HELMUESE

Konferenca,
duke miratuar Konventën Ndërkombëtare mbi Gatishmërinë, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC);
duke vënë re nenin 38(a) të Konventës mbi Organizatën Ndërkombëtare Detare në lidhje me funksionin e Komitetit të Mbrojtjes së Ambientit Detar të Organizatës në lidhje me kryerjen e këtyre funksioneve të tilla që i janë ngarkuar ose mund t'i ngarkohen Organizatës nga ose në bazë të konventave ndërkombëtare;
duke njohur që ndotja detare nga derdhjet aksidentale të substancave të rrezikshme dhe të dëmshme në ujë, mund të kërcënojnë ambientin detar dhe interesat e shteteve bregdetare;
duke njohur gjithashtu që ekzistenca e instrumenteve ndërkombëtare që trajtojnë transportin e materialeve të rrezikshme dhe rezolutën e Asamblesë A.676(16) mbi lëvizjen ndërkufitare të mjetëve të rrezikshme;
duke pasur parasysh gjithashtu që shumë nga konventat dhe marrëveshjet ekzistuese rajonale mbi bashkëpunimin në luftën kundër incidenteve të ndotjes detare zbatohen për naftën dhe për substancat e tjera të dëmshme;
duke konsideruar të dëshirueshme që objekti i Konventës OPRC duhet të zgjerohet për t'u zbatuar, plotësisht ose pjesërisht, në incidentet e ndotjes detare që përfshijnë substanca të rrezikshme dhe të dëmshme;
duke konsideruar gjithashtu që është e dëshirueshme që, në masën që është e realizueshme dhe e përshtatshme, Konventa OPRC të zbatohet nga Palët në të për incidentet e ndotjes detare që përfshijnë substanca të rrezikshme dhe të dëmshme, të ndryshme nga nafta;
duke besuar që mënyrat dhe mjetet e reagimit ndaj një incidenti të ndotjes detare që përfshin substanca të rrezikshme dhe të dëmshme, janë të ndryshme në aspekte të ndryshme nga ato që ofrohen për gatishmërinë dhe reagimin ndaj ndotjes nga nafta;

duke njohur më tej punën në vazhdim të Organizatës në lidhje me zhvillimin e një regjimi ligjor ndërkombëtar për përgjegjësinë dhe kompensimin, në lidhje me transportin detar të substancave të rrezikshme dhe të dëmshme dhe nevojën për miratimin e shpejtë të një konvente për këtë temë:

1. *fton* Organizatën Detare Ndërkombëtare për të filluar punën për të zhvilluar një instrument për të zgjeruar objektin e Konventës OPRC për t'u zbatuar, plotësisht ose pjesërisht, në incidentet e ndotjes nga substanca të rrezikshme të ndryshme nga nafta dhe të përgatisë një propozim për këtë qëllim;

2. *nxit* Palët e Konventës OPRC për të zbatuar dispozitat e përshtatshme të Konventës në masën e duhur dhe sipas rastit, për substancat e rrezikshme dhe të dëmshme, në pritje të miratimit dhe të hyrjes në fuqi të një instrumenti për të mbuluar këto substanca.

Janar 2007

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 27.3.2007
Doli nga shtypi më 29.3.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 40 lekë